

VENDIM
Nr. 86, datë 30.12.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 19.12.2024 dhe 30.12.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 12 (P) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: PËLLUMB GJOKA, përfaqësuar nga avokatët: Ylli Manjani, Gurali Brahimllari dhe Ledi Bianku, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Genci Gjonçaj.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Engjëll Agaçi.

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR, përfaqësuar nga drejtuesi Altin Dumani dhe prokurori Arben Kraja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 94, datë 23.7.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 97, datë 29.7.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 38, datë 31.8.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për pjesën që kanë disponuar për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuesit.

Shfuqizimi i shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, dhe i pikës 4, të nenit 6, si dhe pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës Shqipërisë, për shkak se cenojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve të posaçëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, pika 2, shkronja “c”, 28, pika 3, 31, shkronjat “a” dhe “b”, 32, pika 2, 36, 42, 43, 116, 121, 131, pikat 1, shkronja “f” dhe 2, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, 6, 7, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 43/b, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*),

Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 9.1.2023 shtetasit L.Z. dhe D.Z. (nënë e bir) kanë paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryera në bashkëpunim në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 186, 287 dhe 333/a të Kodit Penal (KP). Kallëzuesit janë trashëgimtarë të shtetas D.H.(Gj.) dhe kanë pretenduar se pasuria e paluajtshme e trashëgimlënësës së tyre, një sipërfaqe toke që ndodhet në fshatin Pulaj, Velipojë, Shkodër, është tjetërsuar dhe marrë në mënyrë të paligjshme nga shtetasi Pëllumb Gjoka (*kërkuesi*) në bashkëpunim me disa shtetas të tjerë.

2. Mbi bazën e këtij kallëzimi penal Prokuroria e Posaçme në datën 16.1.2023 ka regjistruar procedimin penal nr. 9 të vitit 2023 (*procedimi penal nr. 9/2023*) për veprat penale “Falsifikimi i dokumenteve” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të kryera në bashkëpunim, në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 186, 287 dhe 333/a të KP-së.

3. Në vijim, Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) ka përcjellë në Prokurorinë e Posaçme aktin “Informacion për referimin e veprës penale” të datës 10.3.2023, bazuar në informacionin e dërguar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim në Zbatimin e Ligjit (*Europol*), në muajin janar 2023, përmes të cilit janë përcjellë të dhëna nga komunikimet e disa përdoruesve që ishin shtetas shqiptarë, të cilët dyshoheshin se ishin përfshirë në veprimtari kriminale, duke u koordinuar me njëri-tjetrin nëpërmjet komunikimeve të enkriptuara në aplikacionin Sky ECC përmes kodeve pin përkatës. Informacioni i Europol-it ishte i bazuar në rezultatet e hetimeve të autoriteteve të drejtësisë franceze në kuadër të një procedimi penal të quajtur operacioni “Vanilla”.

4. Në datën 13.3.2023, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 41 të vitit 2023 (*procedimi penal nr. 41/2023*), për veprat penale “Vrasja me paramendim”, “Heqja e paligjshme e lirisë”, “Shpërdorimi i detyrës”, “Ekspertimi i remë”, “Falsifikimi i dokumenteve”, “Trafikimi i narkotikëve”, të kryera në bashkëpunim, në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 78, 110, 248, 309, 186, 283/a, 333/a, 334 dhe 287 të KP-së.

5. Në datën 17.3.2023, për qëllime të hetimeve paraprake që po zhvilloheshin për procedimin penal nr. 41/2023 Prokuroria e Posaçme i ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë kërkesën për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore franceze, ku kërkohej të gjitha komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC nga përdoruesit e disa kodeve pin. Në datën 27.3.2023, Ministria e Drejtësisë i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Francës kërkesën e Prokurorisë së Posaçme.

6. Në datën 8.6.2023 Ministria e Drejtësisë i ka përcjellë Prokurorisë së Posaçme përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Francës lidhur me ekzekutimin e kërkesave të mësipërme për ndihmë juridike, ku ndërmjet dokumenteve shoqëruese është dërguar edhe një CD me përmbajtjen e komunikimeve të përdoruesve të disa kodeve pin në aplikacionin Sky ECC. Në datën 3.7.2023, këto akte i janë përcjellë Prokurorisë së Posaçme të përkthyer në shqip nga Ministria e Drejtësisë.

7. Në datën 30.6.2023, Prokuroria e Posaçme i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë kërkesën për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore franceze, përmes së cilës kërkohej të gjitha komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC nga përdoruesit e 21 kodeve pin. Në datën 11.7.2023 Ministria e Drejtësisë ia ka përcjellë kërkesën Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Francës.

8. Pas administrimit të provave të përcjella përmes letërporosive të autoriteteve të drejtësisë franceze, në datën 18.7.2023 janë regjistruar emrat e personave nën hetim, ndër të cilët edhe kërkuesi.

Në datën 19.7.2023, Prokuroria e Posaçme ka vendosur bashkimin e procedimeve penale nr. 9/2023 dhe nr. 41/2023 në një procedim penal të vetëm të numërtuar me nr. 9/2023, në kushtet kur personat e dyshuar po hetoheshin në kuadër të dy procedimeve penale dhe provat e tyre ndikonin në provueshmërinë e fakteve penale që po hetoheshin.

9. Po gjatë hetimeve ka rezultuar se në datën 24.6.2020, mbi bazën e informacioneve të organeve ligjzbatuese, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (*Prokuroria Shkodër*) ka regjistruar procedimin penal nr. 751 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 751/2020*), për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së, mbi dyshimin se shtetasja D.H.(Gj), në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës, ka përfutur tokë në mënyrë të paligjshme duke përdorur dokumente të falsifikuara. Po kështu, në datën 29.7.2020 shtetasja L.Z. ka paraqitur kallëzim penal për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” lidhur me kryerjen nga përfaqësuesi me prokurë i D.H.(Gj.), të veprimeve në mashtrim të ligjit, deri në tjetërsimin e pasurive të paluajshme të trashëgimlënësës së saj. Ky kallëzim penal, duke qenë se kishte lidhje me procedimin penal nr. 751/2020, është administruar si material shtesë në kuadër të këtij procedimi. Në vijim, mbi kallëzimin penal të shtetasit D.M., Prokuroria Shkodër ka regjistruar edhe procedimin penal nr. 988 të vitit 2020, po për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Këto dy procedime penale janë bashkuar në një procedim të vetëm me nr. 751/2020. Gjithashtu, mbi bazën e kallëzimit po të shtetas L.Z. ndaj kërkuesit Pëllumb Gjoka dhe shtetasit S.B., me pretendimin se ata kanë vjedhur pronën e nënës së saj, duke shfrytëzuar prokurën e lëshuar nga kjo e fundit, me të cilën i ka dhënë tagra shtetasit A.B., Prokuroria Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. 419 të vitit 2022 për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së. Duke qenë se ky procedim lidhet me faktin e procedimit penal nr. 751/2020 është bashkuar me këtë të fundit. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria Shkodër ka paraqitur në gjykatë kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 751 të vitit 2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i KP-së.

10. Ka rezultuar, gjithashtu, gjatë hetimeve, se në kuadër të procedimit penal nr. 751/2020 Prokuroria Shkodër ka administruar edhe aktet e ekspertimit grafik të nënshkrimeve dhe vulave në dokumentet arkivore të përdorura në procesin e njohjes së pronësisë së shtetas D.H.(Gj.) nga përfaqësuesit e saj me prokurë. Nga këqyrja e komunikimeve në aplikacionin Sky ECC midis përdoruesit me kodin pin të identifikuar në përdorim të kërkuesit dhe përdoruesit me kodin pin të identifikuar në përdorim të prokurorit Xh.L., është evidentuar një komunikim që përmban 4 fotografi të një dokumenti që ngjason shumë me këtë akt ekspertimi grafik. Nga komunikimi, që i përket periudhës nga data 16.2.2021 deri në datën 18.2.2021, tri ditë përpara kryerjes së aktit të ekspertimit, konstatohet përfshirja dhe angazhimi i tyre për kompromentimin e konkluzioneve të këtij akti.

11. Në datën 21.7.2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) kërkesën për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), edhe ndaj kërkuesit, për shkak të dyshimeve se ai është përfshirë në veprimtari të paligjshme, që lidhen me vrasjen e një shtetasi, sigurimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e vrasjes së disa shtetasve të tjerë, korrupsionin aktiv të gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, si dhe mbajtjen pa leje të armëve, të dyshuara se janë kryer në formën e veçantë të bashkëpunimit, atë të grupit të strukturuar kriminal.

12. Pas shqyrtimit të kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 94, datë 23.7.2023 (*vendimi nr. 94/2023*), ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, për kërkuesin dhe personat e tjerë nën hetim, me arsyetimin se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova se ata kanë konsumuar veprat penale për të cilat dyshohen. Sipas asaj gjykate, krahas të dhënave që kanë rezultuar nga hetimi, një rol të rëndësishëm në drejtim të zbardhjes së fakteve penale dhe të të dyshuarve kanë pasur të dhënat e marra nga komunikimet me aplikacionin Sky ECC.

13. Në datën 27.7.2023, Policia Gjyqësore ka ekzekutuar masat e sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuara nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ndër ata edhe ndaj kërkuesit, ndërkohë që në datën 28.7.2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për marrjen në pyetje të të arrestuarve, përfshirë edhe të kërkuesit.

14. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 97, datë 29.7.2023 (*vendimi nr. 97/2023*), për sa i përket kërkesit, ka vendosur vazhdimin e zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, me arsyetimin se pas marrjes në pyetje në përputhje me nenin 248 të KPP-së, verifikohet ekzistenca e kushteve dhe kriterëve për masën e sigurimit të caktuar dhe të zbatuar ndaj tij, ndërsa nevojat e sigurimit vijnë të jenë të pandryshuara. Kundër vendimeve të GJKKO-së së Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal ka paraqitur ankim kërkuesi.

15. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 38 (87-2023-184), datë 31.8.2023 (*vendimi nr. 38/2023*), ka vendosur, ndër të tjera, miratimin e vendimeve nr. 94/2023 dhe nr. 97/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë në lidhje me masën e sigurimit personal të vendosur për kërkuenin, pasi ka vlerësuar se shkakët e paraqitura në ankim nuk janë të bazuara në fakt dhe në ligj. Ajo gjykatë ka arsyetuar se rasti në shqyrtim ka të bëjë me një procedim të lidhur, ku organi i akuzës ka kryer veprime të shumta hetimore në lidhje me disa fakte penale përkundrejt një numri të madh të hetuarish, veprime që kanë kulmuar me marrjen e provave nga autoritetet gjyqësore franceze, të cilat nga kryqëzimi me provat e tjera të marra nga organi procedues, si në kohën e kryerjes së veprave penale, ashtu edhe në vijim në tërësinë e tyre, vërtetojnë dyshimin e arsyeshëm se të hetuarit mund të kenë kryer veprat penale që u janë atribuar. Po sipas GJKKO-së së Apelit, autoritetet e drejtësisë shqiptare u kanë kërkuar autoriteteve gjyqësore franceze, me letërporosi, marrjen e provave të administruara nga to gjatë procedimit penal “Vanilla”. Letërporosia është pranuar nga autoritetet gjyqësore franceze, që në ekzekutim të saj kanë marrë provat, duke proceduar në përputhje me normat procedurale penale të parashikuara nga neni 3, paragrafi 1, i Konventës së Këshillit të Evropës, si dhe neni 509 i KPP-së. Sipas nenit 510 të KPP-së, vlera që kanë aktet e marra me letërporosi i bën plotësisht të përdorshme, pasi shteti francez nuk ka vënë asnjë kusht për përdorshmërinë e akteve nga autoritetet gjyqësore shqiptare. Provat e marra me letërporosi janë prova dokument dhe për sa kohë që është në fuqi prezumimi i ligjshmërisë së veprimtarisë së zhvilluar nga autoritetet gjyqësore të shtetit të huaj, GJKKO-ja e Apelit e ka çmuar korrekte procedurën e marrjes së provave dhe zgjidhjen e çdo çështjeje eventuale në lidhje me përdorshmërinë e provave të marra përmes letërporosisë (*shih faqet 13, 19 dhe 22 të vendimit nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit*). Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

16. Ndërkohë, në lidhje me kërkesën e datës 30.6.2023 të Prokurorisë së Posaçme për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve gjyqësore franceze, në datën 23.11.2023 Eurojust-i ka dërguar në mënyrë të drejtpërdrejtë, me anë të postës elektronike zyrtare, përgjigjen dhe të dhënat e autoriteteve gjyqësore franceze.

17. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit për kërkuenin, duke vlerësuar se vendimi i GJKKO-së së Apelit është marrë në zbatim dhe interpretim të drejtë të ligjit penal material e procedural dhe se gjykatat e faktit kanë arsyetuar drejt në këtë fazë të procesit në lidhje me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Duke i konsideruar të përdorshme provat e administruara deri në këtë moment të këtij procedimi penal, Kolegji Penal ka vlerësuar se gjykatat e faktit e kanë argumentuar drejt ekzistencën aktuale të nevojave të sigurimit dhe garantimin e këtyre nevojave me vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg”, si masa më e përshtatshme dhe në përputhje me nevojat e sigurimit të vlerësuara për kërkuenin.

18. Në datën 26.4.2024, Prokuroria e Posaçme ka dërguar në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. 9/2023 në ngarkim të kërkuetit dhe personave të tjerë. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj kërkeje, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 77, datë 8.11.2024, ka vendosur pranimin e saj dhe dërgimin për gjykim të çështjes penale.

19. Në datën 7.5.2024, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 28.6.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 15.7.2024, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe thirrjen si subjekt të interesuar të Prokurorisë së Posaçme.

20. Në parashtrimet e datës 17.9.2024, kërkuesi ka paraqitur edhe kërkesë për shtimin e objektit të ankimit kushtetues individual për shfuqizimin e neneve 6, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4, si dhe 42, pika 2, të ligjit nr. 95/2016, si të papajtueshme me Kushtetutën. Në lidhje me këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve, në datën 12.11.2024, bazuar në përmbajtjen e nenit 30, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese që parashikon se kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërkit, vendosi shtimin e objektit të ankimit kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

21. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

21.1 *E drejta për liri dhe siguri, e garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 1, i KEDNJ-së* në këto aspekte:

21.1.1 *Nuk është respektuar parimi i pavarësisë dhe i paanshmërisë* si nga gjykatat, ashtu edhe nga përmbajtja e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (ligji nr. 95/2016), pasi:

21.1.1.1 Për sa i përket gjykimit për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit kanë qenë të njëanshëm, duke pranuar çdo kërkesë të Prokurorisë së Posaçme dhe paragjykuar kërkuesin, si dhe duke cenuar edhe *parimin e prezumimit të pafajësisë* dhe *të së drejtës për t’u ankuar për ligjshmërinë e paraburgimit përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor*. Ata kanë pranuar kërkesën për caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit dhe kanë urdhëruar vazhdimin e paraburgimit të tij, në mungesë flagrante të provave që vërtetonin kushtin thelbësor të “dyshimit të arsyeshëm” për pjesëmarrje në veprimtari kriminale dhe duke mos trajtuar në baraspeshë kërkimet e Prokurorisë së Posaçme me argumentet kundërshtuese të mbrojtësve ligjorë të kërkuesit. Paraburgimi i tij është vendosur *a priori*, bazuar në akte dhe prova që nuk janë shqyrtuar kurrë nga gjykatat, pasi nuk gjenden në fashikullin e gjykimit që shoqëron kërkesën për caktimin e masës së sigurimit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka arsyetuar për argumentet e mbrojtjes për papërdorshmërinë e transkripteve të bisedave të komunikimeve të marra nga autoritetet e huaja, ndërsa në arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit duket haptazi njëanshmëria e vlerësimit të provave, me qëllim justifikimin e mbajtjes në paraburgim, në mënyrë arbitrare, të kërkuesit. Ajo gjykatë ka lejuar edhe shtrembërimin e përmbajtjes së akteve të fashikullit të gjykimit (deformimin e përmbajtjes së letërporosisë së datës 17.3.2023) apo zbatimin *a priori* dhe në mënyrë të njëanshme të parimeve të një instrumenti të bashkëpunimit ndërkombëtar të paaplikueshëm në rastin në gjykim, siç është Konventa Evropiane “Për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale”, e cila gjen zbatim ndërmjet vendeve të Bashkimit Evropian (BE).

21.1.1.2 Për sa i përket përmbajtjes së dispozitave të ligjit nr. 95/2016, nenet 4, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4, si dhe 42, pika 6, të tij i detyrojnë gjyqtarët e gjykatave të posaçme që të pranojnë se që nga momenti i emërimit do të jenë nën vëzhgimin e një oficeri hetues të emëruar nga drejtori i BKH-së, mbikëqyrje e cila mbulon të gjitha komunikimet elektronike dhe komunikimet e tjera të tyre e të familjarëve. Mbikëqyrja është e pakufizuar, kryhet pa ndonjë arsye specifike apo dyshim të arsyeshëm dhe nuk miratohet *a priori* ose kontrollohet *a posteriori* nga ndonjë gjykatë lidhur me proporcionalitetin e ndërhyrjes. Këto dispozita i kanë dhënë “pushtet” kontrollues BKH-së, përderisa oficerët e kësaj strukture kanë të drejta të pakufizuara që të mbajnë nën vëzhgim edhe korrespondencat edhe llogaritë bankare. Thjesht ngritja e kësaj strukture vëzhguese sipas nenit 42 të ligjit nr. 95/2016, është fakt i mjaftueshëm për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të posaçëm. Për rrjedhojë, këto dispozita cenojnë edhe *parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve* dhe të *pavarësisë së pushtetit gjyqësor*, të garantuara nga nenet 4, 7 dhe 145 të Kushtetutës, pasi i privojnë gjyqtarët e GJKKO-ve të Shkallës së Parë dhe të Apelit nga e drejta e fshehtësisë së korrespondencës dhe e drejta për jetë private, duke cenuar jo vetëm garancitë e nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, por ato, *de facto*, përbëjnë presion të vazhdueshëm mbi vullnetin e këtyre gjyqtarëve. Formulimi i neneve 6 dhe 42 të ligjit nr. 95/2016 nuk është në përputhje me Kushtetutën,

edhe pse qëllimi i ligjvënësit është nxitur nga dëshira për të luftuar korrupsionin mes anëtarëve të strukturës së re që është krijuar.

21.1.2 *Provat janë mbledhur në mënyrë të paligjshme:*

21.1.2.1 *Transkriptet janë përgjime*, si të tilla ato janë të papërdorshme dhe të pavlefshme, pasi janë siguruar nga autoritetet franceze dhe shqiptare pa verifikuar përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me atë të vendit të origjinës. Përdorimi i tyre duhej verifikuar sipas neneve 221–226 të KPP-së në lidhje me nenin 151/3 të këtij kodi. Rezultatet e përgjimeve janë të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme në raport me përcaktimet e neneve 226 e 511 të KPP-së dhe në shkelje të garancive të neneve 2, 5, 122, 27, pika 2, shkronja “c” dhe 32 të Kushtetutës. Po kështu, ato ndërhyjnë në lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës, e cila lejohet vetëm sipas kushteve të përcaktuara në nenet 221–226 të KPP-së. Transkriptet e nxjerra nga përgjimet janë të pavlefshme edhe pasi në fashikullin gjyqësor nuk është paraqitur certifikata e vërtetësisë së deshifrimit të mesazheve të koduara dhe as nuk janë përfshirë vendimet e gjykatës franceze që legjitimonin përgjimin, mangësi që përbëjnë shkak për pavlefshmërinë e aktit dhe papërdorshmërinë e tij si provë. Përgjimet janë autorizuar për llogari të një procesi penal, ku kërkuesi nuk ka qenë i dyshuar. Po kështu, transkriptet janë të papërdorshme edhe sepse janë në kundërshtim me nenin 100-8 të Kodit të Procedurës Penale francez, që parashikon se gjyqtari hetues e njofton këtë përgjim tek autoriteti kompetent i shtetit përkatës dhe mungesa e njoftimit përbën shkak për pavlefshmëri të procedurës.

21.1.2.2 *Përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze ishte i padrejtuar*, ndaj përbën përgjim masiv, i cili nuk përfshihet në ato raste që lejon neni 221, pika 3, i KPP-së, pra është i ndaluar, si dhe është realizuar me mjete teknike që nuk parashikohen nga ligji procedural shqiptar. Transkriptet e dërguara me CD nuk janë prova me dokument ose prova digjitale të gjendura dhe të sekuestruara në serverët e platformës Sky ECC, sikurse kanë arsyetuar gjykatat. Në kushtet kur këto transkripte janë rezultate të përgjimeve të kryera në kohë reale, përdorimi i tyre si provë edhe në lidhje me justifikimin e dyshimit të arsyeshëm për pjesëmarrje në vepra penale kushtëzohet nga dispozitat procedurale të të dyja vendeve. Sipas legjislacionit francez të interpretuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ato nuk mund të përdoren kundër kërkuesit, i cili nuk ka pasur mundësi ta kundërshtonte këtë procedurë përpara gjykatës franceze.

21.1.2.3 *Përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze cenon sovranitetin shtetëror të Republikës së Shqipërisë*, pasi në kohën e kryerjes së përgjimeve në aplikacionin Sky ECC, përdoruesi i kodit pin të atribuar kërkuesit rezulton se ka qenë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet shqiptare as nuk janë njoftuar, as nuk kanë dhënë leje për kryerjen e tyre nga autoritetet gjyqësore franceze. Autoritetet shqiptare kanë ardhur në dijeni në muajin janar 2023, kur Europol-i ka dërguar informacion me shkrim për BKH-në, fakt ky që nuk mund të anashkalohej nga gjykatat. Gjyqtari francez ka autorizuar vendosjen e sondës përgjuese në fluksin e të gjitha bisedave ndërmjet abonentëve të Sky ECC, duke e shtrirë përgjimin edhe përtej territorit francez, ndonëse kjo ndalohej edhe nga neni 100-8 i Kodit të Procedurës Penale francez.

21.1.2.4 *Autoritetet gjyqësore shqiptare nuk kanë pasur autorizim nga autoritetet franceze për përdorimin e transkripteve në procesin penal të kërkuesit*. Autoritetet franceze kanë vendosur kufizime për autoritetet shqiptare për përdorimin e transkripteve të dërguara përmes letërporosisë, bazuar në interpretimin e vendimit të Këshillit Kushtetues Francez të datës 8.4.2022 dhe deklarimit në letërporosinë e datës 17.3.2023.

21.1.3 *Janë shkelur parimet e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale” dhe dy protokolle shtesë të saj*. Gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh faktin se instrumentet ndërkombëtare të aplikuara nga pala shqiptare dhe ajo franceze, në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, janë të ndryshme. Letërporosia e dërguar nga pala shqiptare është bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale”, ndërkohë që pala franceze e ka ekzekutuar letërporosinë në bazë të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988, kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope. Ndaj, këto të dhëna nuk mund të përdoren për hetimin dhe gjykimin e veprave penale të ndryshme nga ato që kanë të bëjnë me trafikimin e lëndëve narkotike. As GJKKO-ja e Apelit, as Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk i kanë dhënë përgjigje këtij pretendimi me natyrë kushtetuese të ngritur nga kërkuesi. GJKKO-ja e Apelit ka zbatuar në mënyrë të

shtrembëruar parimet e Traktatit të BE-së dhe Konventës “Për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale”, ndërsa Kolegji Penal, jo vetëm nuk e ka korrigjuar këtë qëndrim, por nuk ka marrë në konsideratë as përcaktimet e Direktivës 2014/41/BE, datë 3.4.2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Për urdhrin e hetimit evropian në çështjet penale” (UHE).

21.1.4 *Nuk ka dyshime të arsyeshme se kërkuesi ka kryer vepra penale*, pasi nuk ekziston asnjë provë konkrete që ta lidhë atë drejtpërdrejt me veprat penale për të cilat është akuzuar. Kërkuesi ka deklaruar se nuk ka asnjë lidhje me përdoruesin e kodit pin të atribuuar atij. Procedura e ndjekur nga BKH-ja për identifikimin e abonentit të këtij kodi pin është bërë në bazë të një procedure të dyshimtë identifikimi, sipas procesverbalit të datës 18.7.2023 të hartuar nga oficerët e BKH-së në kundërshtim me përcaktimet e nenit 295 të KPP-së. Prokuroria e Posaçme nuk ka ndërmarrë masa hetimore shtesë, duke u dhënë vlerë të paracaktuar rezultateve të paligjshme të përgjimeve të kryera në shtetin francez. Në të njëjtën mënyrë kanë vepruar edhe gjykatat, të cilat kanë pranuar *a priori* supozimet e prokurorisë, duke mos i dhënë përgjigje këtij pretendimi të ngritur në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023. Rezultatet e përgjimeve të bisedave të kryera prej abonentit me kod pin të atribuar kërkuesit, janë të papërdorshme, pasi janë autorizuar për llogari të një procesi penal, ku ai nuk ka qenë i dyshuar si pjesëmarrës për kryerjen e atyre veprave penale. Kufizimi i lirisë së kërkuesit në kushtet e mungesës së *ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm* të bazuar në prova, sipas nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, cenon edhe *parimin e ligjshmërisë*. Prokuroria nuk ka bërë transparencë lidhur me aktet që shërbyen për regjistrimin e procedimit penal nr. 41/2023, si dhe mbetet e pasqaruar mënyra dhe kriteri mbi të cilin përzgjedhi miliona mesazhe të shkëmbyera për të përzgjedhur gjashtë kodet pin, ndër të cilat edhe kodin që i atribuohet *apriori* kërkuesit. Në ndryshim nga rasti i kërkuesit, në rastet e referuara nga Prokuroria e Posaçme, transkriptet e komunikimeve jo vetëm nuk kanë qenë prova të vetme për të dyshuarit për kryerjen e veprave penale, por këto transkripte janë konfirmuar në kohë reale me anën e veprimeve të tjera hetimore procedurale, që kanë sjellë identifikim të sigurt të tyre, sikurse kanë qenë vëzhgimet, kontrollet, përgjimet etj. Aktet procedurale që janë paraqitur nga Prokuroria e Posaçme në një volum të ri hetimor në seancën paraprake të zhvilluar në GJKKO-në e Shkallës së Parë, janë marrë nga procedimi penal nr. 26/2024 përmes një procedure të parregullt, pasi ato nuk janë kërkuar dhe nuk janë marrë me letërporosi shtesë për llogari të procedimeve penale nr. 41/2023 dhe nr. 9/2023, por janë dërguar nga autoritetet franceze me ndërmjetësimin e Eurojust-it, në ekzekutim të letërporosisë së dërguar nga prokurori i ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. 26/2024. Aktet e volumit të ri hetimor janë marrë përmes një procesverbali të mbajtur në datën 26.5.2024, bazuar në nenet 193 dhe 303 të KPP-së, dispozita që nuk mund të justifikojnë marrjen e këtyre dokumenteve nga dosja e procedimit penal nr. 26/2024.

21.2 *E drejta për shqyrtim të shpejtë të ankimit ose për procedim në gjendje të lirë kundrejt garancisë pasurore*, e garantuar nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5 paragrafët 3 dhe 4, i KEDNJ-së në aspektet e mëposhtme:

21.2.1 *Është mohuar e drejta për t’u ankuar përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor*, pasi gjyqtarët e GJKKO-së së Apelit që kanë shqyrtuar ankimin, duke qenë, për shkak të funksionit, nën përgjimin e një hetuesi pjesë e strukturës hetimore që është pala tjetër në këtë procedurë, nuk mund të pretendohet të jenë të pavarur.

21.2.2 *Është shkelur e drejta për të pasur kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe ankimin efektiv*, pasi mbrojtësit e kërkuesit nuk janë lejuar të njihen me aktet dhe provat mbi të cilat është vendosur masa e arrestit. Mungesa e aktit “Informacion” të Europol-it ka penguar njohjen me përmbajtjen e tij dhe me mënyrën e regjistrimit të procedimit penal nr. 41/2023. Ky akt është shmangur tërësisht nga debati gjyqësor dhe gjykatat, duke u pajtuar me vlerësimin e organit të akuzës për mbajtjen sekret të përmbajtjes së tij, nuk i kanë dhënë mundësi kërkuesit të njihet me të. Edhe vendimet gjyqësore të autorizimit të përgjimeve dhe lejit të zgjatjes së afateve të tyre nuk janë dorëzuar nga Prokuroria e Posaçme as në Gjykatën e Lartë deri në datën 22.12.2023, kur është shqyrtuar rekursi i kërkuesit. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka shkelur të drejtën e mbrojtësve ligjorë për t’u njohur me materialet e çështjes, duke penguar përgatitjen e një mbrojtjeje efektive në seancën gjyqësore për marrjen në pyetje të të arrestuarit. Ata jo vetëm që nuk janë njoftuar në kohë për seancën për marrje në pyetje, por as nuk janë lejuar gjatë seancës që të njiheshin në mënyrë efektive me përmbajtjen e akteve të

dosjes hetimore, duke u pranuar kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për ruajtjen e sekretit hetimor. Njohja me aktet e dosjes ka qenë vetëm vizuale dhe gjykata ka kërkuar nga mbrojtësit ligjorë nënshkrimin e një deklarate përgjegjësie, si dhe ka urdhëruar dorëzimin në sekretari të mjeteve të shkrimit, me qëllim që të mos mbanin asnjë shënim. GJKKO-ja e Apelit, jo vetëm nuk ka pranuar kërkesën e mbrojtësve për njohjen e plotë të akteve dhe provave, por ka kufizuar kohën për të studiuar përmbajtjen voluminoze të fashikullit gjyqësor. Ndonëse kërkesa e mbrojtësve ligjorë është dorëzuar në datën 23.8.2023, mundësia për t'u njohur me fashikullin e gjykimit nga GJKKO-ja e Apelit është dhënë vetëm disa orë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, përmes vendimit të datës 28.8.2023 për pranimin e pjesshëm të kërkesës. Prokuroria e Posaçme ka refuzuar t'i përgjigjej kërkesës me shkrim të datës 29.8.2023 të mbrojtësve ligjorë për njohjen me aktet e dosjes hetimore dhe provat mbi të cilat u justifikua "dyshimi i arsyeshëm" për vendosjen e masës së sigurimit personal për kërkuesin, duke cenuar të drejtën për ankim efektiv në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, ndonëse ka pranuar pjesërisht kërkesën e datës 1.12.2023, duke lejuar mbrojtësit ligjorë të njiheshin dhe të studionin vetëm përmbajtjen e akteve procedurale të çështjes, nuk ka pranuar që të merreshin kopje të njësuara me origjinalin të akteve procedurale të autoritetit gjyqësor të huaj.

21.2.3 *Është shkelur e drejta për t'u liruar kundrejt garancisë pasurore*, pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë respektuar të drejtën e kërkuesit për t'u proceduar në liri, kundrejt *garancisë pasurore*. Në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së gjykatat duhet të pranonin kërkesën për masën alternative të sigurimit personal "Garancia pasurore" sipas nenit 236 të KPP-së dhe duhet t'i kërkonin Prokurorisë së Posaçme të plotësonte dosjen hetimore me akte të tjera që lidheshin me rezultatet e përgjimeve të autoriteteve gjyqësore franceze, ndërkohë që kërkuesi duhej të procedohej në liri. Në vendimet e gjykatave nuk është shqyrtuar dhe nuk është vënë në diskutim kërkimi për ndryshimin dhe zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg".

21.3 *E drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit*, të garantuara nga nenet 28, pika 2, 33, pika 1, dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenet 5, paragrafi 3 dhe 6 të KEDNJ-së, pasi:

21.3.1 *Kërkuesit i është mohuar e drejta për të debatuar dhe kundërshtuar provat* në bazë të të cilave GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sigurimit. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të debatit gjyqësor lidhur me provat dhe aktet, të cilat nuk u paraqitën në seancën gjyqësore për shkak të urdhrit për ruajtjen e sekretit hetimor të datës 21.7.2023 të Prokurorisë së Posaçme. Në fashikullin hetimor mungojnë edhe procesverbalet e certifikimit të vërtetësisë së deshifrimit të komunikimeve të enkriptuara, procesverbalet e këqyrjes, kontrollit dhe sekuestros provuese për serverët e platformës Sky ECC. Në volumin e ri hetimor të Prokurorisë së Posaçme nuk gjenden as letërporosia e datës 14.2.2024, as letërporosia e ekzekutuar nga autoriteti gjyqësor francez, si dhe kushtet për përdorimin e transkripteve dhe provave të tjera, duke mos pasur kërkuesi akses në to. Edhe GJKKO-ja e Apelit nuk ka lejuar paraqitjen dhe verifikimin e provave dhe akteve të fashikullit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 29.8.2023, si dhe debatin e palëve lidhur me to. Edhe mospranimi nga Gjykata e Lartë i kërkesës së kërkuesit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, nuk ka lejuar zhvillimin e debatit mes tyre lidhur me aktet dhe provat.

21.3.2 *Mbrojtësit nuk janë njohur me aktet procedurale të përfuturit të transkripteve*, pasi gjykatat e faktit nuk kanë lejuar njohjen dhe marrjen e kopjeve të transkripteve dhe të akteve procedurale në bazë të të cilave ishte lejuar përgjimi. Vetëm pas paraqitjes së kërkesës së datës 15.5.2024, gjyqtarja e seancës paraprake ka lejuar mbrojtësit ligjorë të kërkuesit që të njihen me dosjen hetimore dhe të marrin kopje të njësuara me origjinalin të disa prej akteve dhe provave në të.

21.4 *E drejta e të arrestuarit për t'u dëgjuar nga gjykata*, e garantuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3, i KEDNJ-së, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka përmblusur detyrimin e parashikuar në nenin 248 të KPP-së për marrjen në pyetje të kërkuesit. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore atij i është kërkuar të deklaronte vetëm gjeneralitetet, ndërkohë që dispozitat e mësipërme garantojnë të drejtën e të arrestuarit që të dëgjohet për versionin e tij kundër kërkesës së organit të akuzës. Edhe Gjykata e Lartë, duke vendosur mospranimin e kërkesës për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për t'u dëgjuar.

21.5 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka caktuar masën e sigurimit personal bazuar edhe në disa akte procedurale, prova të marra në vendngjarje dhe hetime të zhvilluara më parë,

por të pushuara prej kohësh nga gjykatat e faktit për shkaqe të motivuara procedurale. Këto akte janë përfshirë nga prokuroria në fashikullin hetimor të dorëzuar në gjykatë. Edhe pse vendimet gjyqësore për pushimin e çështjes ose të akuzës nuk janë të formës së prerë, marrja e akteve procedurale prej fashikujve të tyre, në kushtet kur ato vendime janë ende në fuqi, është në kundërshtim me normat procedurale. Përdorimi i këtyre provave për të justifikuar “dyshimin e arsyeshëm” për pjesëmarrjen e kërkuarit në kryerjen e veprave penale përbën shkelje të normave procedurale që garantojnë procesin e rregullt ligjor dhe bashkimi i akteve procedurale të procedimeve të pushuara shkel parimet e ligjshmërisë dhe të sigurisë juridike.

21.6 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore janë të paarsyetuara, me përmbajtje jologjike dhe kontradiktore, me referime të shtrembëruara të përmbajtjes reale të akteve dhe provave që gjenden në fashikullin e gjyqësorit, si dhe me mungesa flagrante në drejtim të detyrimit për të shqyrtuar dhe për t’u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit të ngritura në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023, si dhe parashtrimeve të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 29.8.2023. Gjykatat e faktit kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për të njohur arsyet e paraburgimit të tij dhe vendimet e tyre bazohen jo vetëm në transkripte të përgjimeve të paligjshme, por kanë edhe mungesë të akteve që kanë lejuar kryerjen e përgjimeve në vendin e origjinës, në kundërshtim me nenet 32, pika 2 dhe 36 të Kushtetutës. Gjykata e Lartë jo vetëm nuk i ka korrigjuar këto shkelje, por ka pranuar *a priori* arsyetimin e GJKKO-së së Apelit, duke mos përmbushur funksionin e saj si gjykatë ligji lidhur me detyrimin për t’u dhënë përgjigje jo vetëm shkaqeve të rekursit me natyrë kushtetuese, por edhe pretendimeve për shkelje në zbatimin e ligjit material e procedural penal. Kolegji Penal nuk u ka dhënë përgjigje argumenteve shtesë të aktit “*Memorie me shkrim*” të datës 11.12.2023, që janë bazuar në të dhënat e evidencuara në datën 4.12.2023 nga studimi i dosjes hetimore dhe fashikullit gjyqësor.

22. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar si vijon:

22.1 Pretendimet për cenimin e së drejtës për liri dhe siguri, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 1, i KEDNJ-së, janë të pabazuara, pasi:

22.1.1 *Pretendimi për cenimin e parimeve të pavarësisë dhe paanshmërisë nga gjykatat* është i pabazuar, pasi gjyqtarët e GJKKO-ve të Shkallës së Parë dhe të Apelit emërohen nga një organ kushtetues i pavarur, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), i cili siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Nga ana tjetër, prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit. Prokuroria e Posaçme dhe BKH-ja janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Ligji nr. 95/2016 parashikon mjete mbikëqyrëse, si një masë parandaluese kundër korrupsionit në gjykatat e posaçme, por pa cenuar pavarësinë e subjekteve të ligjit. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale vetëm përpara gjykatave të posaçme, të cilat, në mënyrë të pavarur, kontrollojnë veprimet procedurale të këtij organi që në fazat e hetimit paraparak dhe dhënien e miratimit të mjeteve hetimore të mbledhjes së provave. Për sa i përket përmbajtjes së neneve 4, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4, si edhe 42, pika 6, të ligjit nr. 95/2016, krijimi i Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së ishte një ndër themelet e reformës në drejtësi, të cilat, për rëndësinë e tyre, janë parashikuar në nenin 135, pika 4, të Kushtetutës. Parashikimet ligjore të kundërshtuara janë delegim i kësaj dispozite kushtetuese, ndaj kushtetutshmëria e tyre nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata, pasi shfuqizimi i dispozitave të ligjit nr. 95/2016 do të sillte rrëzim të vetë normës kushtetuese. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 janë vlerësuar edhe nga Komisioni i Venecias, i cili ka konfirmuar se respektojnë parimet kushtetuese. Ligji nr. 95/2016 ka kaluar edhe filtrin kushtetues gjatë hartimit të tij nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, duke i dhënë atij legjitimitetin parlamentar bazuar në Kushtetutë. Garancitë procedurale që ofron ligji nr. 95/2016 janë parashikuar edhe në dispozitat vijuese të tij, konkretisht nenet 42, 48, 51 dhe 52. Po kështu, përgjimi i komunikimeve në platformën e koduar Sky ECC është bërë në kuadër të një procedimi penal në Francë dhe autoriteteve të drejtësisë të atij shteti u janë kërkuar, përmes letërporosisë, të dhënat e mbledhura në kuadër të atij procedimi penal, duke përfshirë edhe ekstraktimin e komunikimeve të realizuara përmes platformës Sky ECC. Marrja e të dhënave të ekstraktuara nga këto platforma të koduara komunikimi në kuadër të një procedimi të zhvilluar në një shtet tjetër mund të bëhet sipas nenit 225 të KPP-së, si dhe duke respektuar dispozitat që lidhen me dërgimin e letërporosisë për jashtë

shtetit. Kërkesa mund të bëhet nga prokurori shqiptar, pa qenë e nevojshme marrja e autorizimit paraprak të gjyqtarit.

22.1.2 *Pretendimi se provat janë mbledhur në mënyrë të paligjshme* është i pabazuar:

22.1.2.1 *Pretendimi se transkriptet janë përgjime*, ndaj përdorimi i tyre duhej verifikuar sipas rregullave të KPP-së, është i pabazuar, pasi:

22.1.2.1.1 Provat e formuara dhe të marra nga autoriteti gjyqësor francez janë kërkuar dhe marrë nga Prokuroria e Posaçme në zbatim të dispozitave të KPP-së, ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, të ndryshuar (*ligji nr. 10193/2009*) dhe Konventës së Këshillit të Evropës. Edhe procedura e ndjekur nga autoritetet franceze në kërkimin dhe transmetimin e provave është në përputhje me dispozitat e KPP-së dhe të akteve të mësipërme. Aktet e autoriteteve franceze të drejtësisë prezumohen se janë kryer në përputhje me legjislacionin vendas të atij shteti, ndërkohë që i takon personit nën hetim të dëshmojë se gjatë përgjimit të kryer nga autoritetet franceze janë shkelur dispozitat procedurale të atij shteti.

22.1.2.1.2 Lidhur me transmetimin e përmbajtjes së komunikimeve të shkëmbyera nëpërmjet mjeteve të koduara, të marra dhe të deshifruara nga autoriteti i huaj në një procedim penal që është duke u zhvilluar përpara tij, i kërkuar nëpërmjet UHE-së, Gjykata e Kasacionit e Italisë, në vendimin njëses nr. 23755, datë 29.2.2024, ka mbajtur qëndrimin se ky transmetim hyn nën regjimin juridik që ka të bëjë me shkëmbimin e provave ndërmjet procedimeve penale, sipas nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale italian që rregullon “*Marrjen e procesverbaleve të provave të procedimeve të tjera*”, si dhe të nenit 270 të këtij Kodi që rregullon “*Përdorimin e (transkriptimeve të përgjimeve) në procedime të tjera*”. Ndërsa në vendimin tjetër njëses nr. 23756, datë 29.2.2024, në lidhje me marrjen e rezultateve të përgjimeve të urdhëruara nga një autoritet gjyqësor i huaj, në një procedim penal që është duke u zhvilluar përpara tij dhe të kryera në një platformë të koduar, Gjykata e Kasacionit e Italisë ka mbajtur qëndrimin se i nënshtrohet disiplinës së përcaktuar në nenin 270 të Kodit të Procedurës Penale italian. Referuar kësaj jurisprudence, të dhënat e komunikimeve të koduara të marra në kuadër të një procedimi penal të huaj nga një autoritet gjyqësor i huaj konsiderohen përgjime dhe, si të tilla, duhet të respektojnë nenet 221–226 të KPP-së. Pra, që këto të dhëna të jenë të përdorshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse ekstraktimi i bisedave është bërë ndaj shtetasve që në kohën e komunikimit ndodheshin në këtë territor, kërkohet, së pari, që ky ekstraktim/përgjim të bëhet për vepra të parashikuara në nenin 221, paragrafi 1, të KPP-së, si dhe në kushtet e nenit 226 të KPP-së. Kjo nuk përjashton respektimin e dispozitave procedurale penale që lidhen me disiplinën e përgjimit sipas legjislacionit të vendit ku është urdhëruar ky ekstraktim/përgjim bisedash, i cili duhet të jetë i autorizuar nga organi kompetent në shtetin ku ai është urdhëruar në kuadër të procedimit të atij shteti. Në rastin e të dhënave të përfutuara nga platforma Sky ECC, të cilat janë dekriptuar në Francë, autorizimi për marrjen e të dhënave të dekriptimit është dhënë nga gjyqtari hetues, sipas nenit 100 të Kodit të Procedurës Penale francez.

22.1.2.1.3 Provat e përfutuara nga përgjimi dhe kapja e të dhënave të kriptuara nga aplikacioni Sky ECC janë krijuar jashtë territorit të Shqipërisë dhe janë siguruar në bazë të bashkëpunimit ndërkombëtar, duke ndjekur të gjitha procedurat e kërkuara për t’u pranuar si prova në gjykatat shqiptare sipas ligjit nr. 10193/2009 dhe dispozitave të KPP-së. Hetimi i kryer në Francë ka pasur për objekt vetë platformën Sky ECC, duke e trajtuar atë si një grup/organizatë kriminale, ndaj edhe përgjimi është drejtuar drejt serverëve të kësaj shoqërie me vendndodhje në Francë. Në praktikën e transmetuar nga shteti francez rezulton qartë se si ka filluar procedimi penal, cili ka qenë objekti i hetimit, si dhe fakti se kanë qenë oficerët e Policisë Gjyqësore ata që kanë dokumentuar nga pikëpamja procedurale realizimin e përgjimit etj. Kopja e këtij dokumentacioni i është vënë në dispozicion mbrojtësve ligjorë të kërkuesit gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor përpara gjyqtarit të seancës paraprake.

22.1.2.1.4 Pretendimi për cenimin e *lirisë dhe fshehtësisë e korrespondencës*, të garantuar nga neni 36 i Kushtetutës, është i pabazuar, pasi gjykatat nuk kanë konstatuar pamundësinë e kërkuesit dhe të mbrojtësve të tij për t’u njohur me aktet e çështjes dhe për të paraqitur pretendime në drejtim të së drejtës për jetë private, aspekt i së cilës është edhe komunikimi telefonik ose me mjete të tjera elektronike. Nenet 221–226 të KPP-së dhe nenet 100-100-8 të Kodit të Procedurës Penale francez përmbushin kriteret e cilësisë së ligjit, në kuptim të qartësisë, aksesueshmërisë dhe parashikueshmërisë,

me qëllim që të shërbejnë si bazë për kufizimin e kësaj të drejte sipas nenit 8, paragrafi 2, të KEDNJ-së, në kuadër të “kufizimit me ligj” të saj.

22.1.2.2 *Pretendimi se përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze ka qenë i padrejtuar*, pasi është realizuar me një mjet teknik që ndërhyr në të gjithë fluksin e bisedave me natyrën e përgjimit masiv, i cili është i ndaluar nga legjislacioni shqiptar, është i pabazuar. Përgjimi është urdhëruar nga një gjyqtar francez, në përputhje me legjislacionin francez dhe referuar neneve 221–226 të KPP-së rezulton se përgjimi i urdhëruar nga gjykatat franceze është në përputhje edhe me dispozitat procedurale penale që rregullojnë përdorimin e përgjimeve si mjet kërkimi prove. Referuar nenit 221 të KPP-së, veprat penale për të cilat është akuzuar kërkuesi, nisur nga marzhi i dënimit, parashikojnë përdorimin e përgjimit si mjet kërkimi të provës. Lejimi i këtij lloji përgjimi kryhet vetëm në bazë dhe në zbatim të vendimit të gjykatës, që në rastin në shqyrtim është vendimi i gjyqtarit hetues francez, si autoriteti kompetent. Po kështu, nuk ndodhemi përpara asnjë prej kushteve ndaluese të përdorimit të përgjimit të parashikuar nga neni 226 i KPP-së. Nga ana e kërkuesit nuk citohet asnjë dispozitë e KPP-së që ndalon lejimin e përgjimit masiv, sikurse pretendohet.

22.1.2.3 *Pretendimi se përgjimi i realizuar nga autoritetet gjyqësore franceze cenon sovranitetin shtetëror të Republikës së Shqipërisë* është i pabazuar, pasi referuar akteve të ardhura me letërporosi nga autoritetet gjyqësore franceze evidentohet qartë se përgjimi nuk është shtrirë në territorin shqiptar dhe nga ana e autoriteteve shqiptare nuk ka pasur asnjë pretendim për cenimin e këtij sovraniteti. Provat e administruara nga autoritetet franceze nuk janë të krijuara në territorin shqiptar, por të marra dhe të krijuara nga një autoritet gjyqësor i huaj në funksion të hetimeve që ai po kryente në mënyrë të pavarur nga procedimi penal i regjistruar nga Prokuroria e Posaçme. Autoritetet franceze të drejtësisë kanë autorizuar kapjen ose përgjimin e serverëve që gjenden në territorin e atij shteti dhe nuk e kanë shtrirë juridiksionin në territorin shqiptar. Edhe pse Shqipëria nuk është vend anëtar i BE-së dhe nuk zbatohet UHE-ja, nëse do të aplikoheshin për analogji të njëjtat standarde, mosrespektimi i detyrimit të njoftimit nuk sjell automatikisht papërdorshmërinë e të dhënave të marra, pasi kjo mund të ngrihet vetëm kur përgjimi është bërë për një veprë penale për të cilën nuk lejohet në shtetin ku ndodhet personi i përgjuar.

22.1.2.4 *Pretendimi se autoritetet gjyqësore franceze nuk u kanë dhënë mandat autoriteteve gjyqësore shqiptare që të përdorin transkriptet e dërguara me letërporosi për hetimin dhe gjykimin e veprave penale për të cilat akuzohet kërkuesi*, është i pabazuar dhe i është nënshtruar edhe shqyrtimit gjyqësor. Në dokumentacionin e dërguar prej tyre autoritetet e drejtësisë franceze nuk kanë shprehur dhe as nuk kanë lënë të kuptohet se ndalohet përdorimi i këtyre akteve për veprat penale që hetohet kërkuesi. Komunikimi me autoritetet gjyqësore të huaja është i normuar nga konventat ndërkombëtare, në të cilat vendi ynë dhe Franca janë palë, të cilat përcaktojnë se kur shtetet dërguese të informacionit kufizojnë shtetet kërkuese në përdorimin e provave të mbledhura dhe të transmetuara. Referuar dokumentacionit të ekzekutimit të letërporosisë nuk rezulton të ketë kufizime të autoriteteve franceze për përdorimin e të dhënave të dërguara në procesin penal që po zhvillohet në Shqipëri ndaj kërkuesit.

22.1.3 *Pretendimi se nuk ka dyshim të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprat penale të cilat i janë atribuar* është i pabazuar, pasi gjatë hetimit është provuar ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprat penale të atribuara. Edhe vendimet gjyqësore kanë arsyetuar rreth provave që krijojnë dyshimin e arsyeshëm dhe transkriptet e komunikimeve të marra nga autoritetet franceze nuk janë e vetmja provë ku është mbështetur vendimmarrja e gjykatave. Provat e tjera shkresore, shkencore dhe ato me dëshmitarë përputhen më së miri me të dhënat e përfutuara nga komunikimet në Sky ECC ndërmjet kërkuesit dhe bashkëpunëtorëve të tjerë në krim. Dyshimi i arsyeshëm për caktimin e një mase sigurimi është forcuar gjatë fazës së mëtejshme të hetimit, ku rezulton se kërkuesi është marrë i pandehur dhe çështja është dërguar për gjykim në GJKKO-në e Shkallës së Parë përpara gjyqtarit të fazës së hetimit paraprak. Nga akti i njoftimit të akuzës dhe kërkesa për dërgimin e çështjes për gjykim rezulton se krahas transkripteve të komunikimeve në platformën Sky ECC janë administruar edhe shumë prova të tjera që provojnë kryerjen e veprave penale. I pabazuar është edhe pretendimi i kërkuesit se ai nuk ka lidhje me përdoruesin e kodit pin përkatës, pasi identifikimi i tij është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 303 të KPP-së. Edhe veprimet e tjera të kryera gjatë fazës së hetimit paraprak

konfirmojnë se përdoruesi i atij kodi pin është kërkuesi. Ky pretendim është shqyrtuar edhe nga gjykatat dhe është rrëzuar si i pabazuar.

22.2 *Lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës për shqyrtim sa më të shpejtë të ankimit ose për procedim të lirë kundër garancisë pasurore, të garantuar nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafët 3 dhe 4, i KEDNJ-së:*

22.2.1 *Pretendimi se i është cenuar e drejta për të pasur kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe ankimin efektiv është i pabazuar.* Nga aktet e fshikullit gjyqësor rezulton se në momentin e ekzekutimit të masës “Arresti në burg”, kërkuesit i është vënë në dispozicion kopje e vendimit gjyqësor për caktimin e saj. Kjo masë është ekzekutuar më 27.7.2023 dhe sipas nenit 248 të KPP-së është proceduar me marrjen e kërkuesit në pyetje dhe verifikimin e kushteve të ekzekutimit të masës së sigurimit brenda 3 ditëve. Nga dita e ekzekutimit të masës së sigurimit deri në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023, kërkuesi dhe mbrojtësit e tij nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë për t’u njohur me aktet dhe provat. Në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023, pas legjitimit të tyre si mbrojtës të tij, avokatët e kërkuesit kanë kërkuar kohë që të njiheshin dhe të merrnin aktet dhe provat që gjendeshin në fashikullin e caktimit të masës së sigurimit. Përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme, në këtë seancë, kanë shprehur dakordësinë e tyre që mbrojtësit të njiheshin me aktet, por jo të merrnin kopje të tyre në këtë fazë të hetimit, për shkak të urdhrat për ruajtjen e sekretit hetimor të datës 21.7.2023. Edhe GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 28.8.2023, ka pranuar kërkesën e mbrojtësve për t’u njohur me aktet e provat e fashikullit për caktimin e masës së sigurimit, duke u dhënë kohë të arsyeshme për këtë qëllim, fakt i pranuar gjatë gjykimit në apel nga një prej mbrojtësve të kërkuesit.

22.2.2 *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u liruar kundrejt garancisë pasurore është i pabazuar,* pasi gjykatat kanë arsyetuar se përse ndaj kërkuesit duhej të caktohej masa e sigurimit e parashikuar nga neni 238 i KPP-së, në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e kësaj mase, duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i KPP-së.

22.3 *Pretendimi se i është cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit,* në kuptim të nenit 28, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 2, të KEDNJ-së, është i pabazuar.

22.3.1 *Pretendimi se është mohuar e drejta për të debatuar dhe kundërshtuar provat është i pabazuar.* Në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023, me objekt marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të masës së sigurimit, kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësve ligjorë, ka parashtruar argumente për kundërshtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për masën e sigurimit personal, ka paraqitur kërkesat e tij përpara gjykatës, si dhe provat shkresore që i ka çmuar të nevojshme. Nga ana tjetër, edhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme kanë kundërshtuar pretendimet e kërkuesit. GJKKO-ja e Apelit, pas debatit gjyqësor, ka marrë në shqyrtim dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit. Për rrjedhojë, nuk rezulton se gjykatat e faktit të kenë vënë kërkuesin në pozita të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, për sa kohë që i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e tij, të parashtruara nëpërmjet mbrojtjes, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuar.

22.3.2 Kërkuesi, në mënyrë abuzive, pretendon se nuk është njohur me aktet e provat që kanë shërbyer për caktimin e masës së sigurimit, duke iu cenuar e drejta për t’u njohur me përmbajtjen e akteve kryesore procedurale që mundësojnë realizimin e përgjimeve, ndërkohë që duke iu referuar akteve të ankimit dhe të rekursit rezulton qartë se këto dy akte janë hartuar në mënyrë të detajuar, vetëm pasi mbrojtësit ligjorë të tij janë njohur me vendimet gjyqësore dhe provat mbi të cilat gjykatat janë mbështetur për dhënien e vendimeve. Gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe sidomos në momentin e përfundimit të tyre, kërkuesi është njohur me çdo akt dhe provë të grumbulluar gjatë kësaj faze. Këtu përfshihen jo vetëm aktet e ardhura me letërporosi, por edhe provat shkresore, akte ekspertimi, deklarime të personave që kanë dijeni gjatë fazës së hetimit paraprak etj. Gjithashtu, kërkuesi është marrë në pyetje me qëllim sqarimin e pozitës së tij dhe qëndrimin në raport me akuzën. Në çështjen objekt shqyrtimi ekzistojnë të gjitha garancitë e duhura, pasi autorizimi për përgjimin në Francë është dhënë nga një autoritet gjyqësor, sikurse është gjyqtari hetues. Si masë paraprake e garancisë, individit ka akses në këto të dhëna pasi ato bëhen publike në procedimin e filluar kundër tij (pasi zbatohet masa e sigurimit ndaj tij ose ushtrohet kontroll) dhe ligjshmëria e përgjimit mund të kundërshtohet përpara autoriteteve gjyqësore, sikurse në rastin konkret.

22.4 Pretendimi se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata, në kuptim të nenit 28, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së është i pabazuar, pasi bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 29.7.2023 evidentohet se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ia ka dhënë fjalën kërkuesit dhe ai është shprehur lidhur me akuzën. Po kështu, gjatë fazës së hetimit paraprak, kërkuesi është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 11.9.2023 dhe në cilësinë e të pandehurit në datën 25.4.2024, duke iu dhënë mundësia që të jepte shpjegime në lidhje me faktet penale për të cilat akuzohet.

22.5 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i paqartë, pasi nuk shoqërohet me prova dhe argumente, për rrjedhojë duhet rrëzuar.

22.6 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pas vendimet gjyqësor përmbushin kriteret e elaboruara në jurisprudencën kushtetuese. Në vendimin e GJKKO-së së Apelit janë pasqyruar palët ndërgjyqëse, objekti i gjykimit, ankuesi dhe shkaqet e ankimit, arsyetimi i vendimit objekt ankimi (i GJKKO-së së Shkallës së Parë) dhe faktet penale që u atribuohen personave nën hetim, përfshirë kërkuesin. Ajo gjykatë i ka dhënë përgjigje shteruese pretendimeve të kërkuesit, siç janë ato për papërdorshmërinë e provave, përshtatshmërinë e masës së sigurimit etj. Edhe vendimi i Kolegjit Penal në pjesën hyrëse të tij përmban palët ndërgjyqëse, objektin e gjykimit, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi. Ajo gjykatë, në referim të akteve dhe duke i ballafaquar ato me shkaqet e rekursit, me të drejtë ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nuk janë të tilla që të mund të ndryshojnë vendimmarrjen e GJKKO-së së Apelit, duke e lënë në fuqi vendimin e asaj gjykate.

23. Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka prapësuar se në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e neneve 4, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4, si edhe 42, pika 6, të ligjit nr. 95/2016, kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, pasi nuk provon interesin e drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm. Sipas këtij subjekti, këto dispozita kanë të bëjnë me organizimin e institucioneve të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe nuk rregullojnë çështje që lidhen me procedurën e vlerësimit dhe caktimit të masave të sigurimit personal. Për këtë arsye, kërkuesi nuk provon cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave të tij nga përmbajtja e dispozitave të kundërshtuara.

24. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e neneve 4, pika 1, shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4, si edhe 42, pika 6, të ligjit nr. 95/2016 se:

24.1 Kërkuesi nuk ka arritur të vërtetojë lidhjen direkte që kanë dispozitat e kundërshtuara me çështjen e tij, pasi ligji nr. 95/2016 ka për qëllim organizimin dhe funksionimin e institucioneve të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe nuk zbatohet ndaj individëve të përfshirë në hetime ose procedura gjyqësore, duke mos qenë kërkuesi subjekt i drejtpërdrejtë i këtyre dispozitave, për sa kohë ato nuk kanë të bëjnë me masën e sigurimit personal të vendosur ndaj tij.

24.2 Pretendimet e kërkuesit për përmbajtjen e dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 95/2016 janë të pabazuara edhe në themel, pasi ato janë reflektim i drejtpërdrejtë i nenit 135, pika 4, të Kushtetutës, që është vlerësuar nga Komisioni i Venecias në opinionin nr. 824/2015. Ligji nr. 95/2016 është miratuar duke pasur parasysh standardet ndërkombëtare, që kërkojnë një balancë të duhur midis nevojës për luftën kundër korrupsionit dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive të individëve, si dhe bazuar në ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në kuadër të reformës në drejtësi. Parashikimet e dispozitave të kundërshtuara lidhen me mbikëqyrjen e gjyqtarëve nga BKH-ja dhe kanë për qëllim parandalimin e korrupsionit dhe mbrojtjen e integritetit të gjyqtarëve dhe sistemit të drejtësisë. Kjo masë mbikëqyrëse konsiderohet si një mjet për të siguruar që gjyqtarët dhe anëtarët e familjeve të tyre të mos jenë të ekspozuar ndaj ndikimeve të jashtme ose korrupsionit. Po kështu, kjo mbikëqyrje është e justifikueshme, duke u mbështetur në nevojën për garantimin e integritetit të një organi gjyqësor që merret me çështje delikate dhe me interes kombëtar. Dispozitat e kundërshtuara parashikojnë të gjithë garancitë procedurale për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, pasi mbikëqyrja është e kontrolluar dhe e kufizuar nga autoritetet e kompetencës, duke përfshirë kontrollin e përshtatshëm të masave të ndërhyrjes dhe kufizimit të të drejtave të individëve.

24.3 Kërkuesi nuk ka paraqitur ndonjë rrethanë që vë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarëve në aspektin objektiv dhe subjektiv. Pretendimet e tij lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, të cilat

duhet të shqyrtohen në kontekstin e procesit të rregullt dhe të ankimohen përmes mjeteve të ankimit gjyqësor dhe jo përmes kërkesës për shfuqizimin e dispozitave të ligjit nr. 95/2016.

III Procesi në gjykimin kushtetues

25. Në parashtrimet e datës 17.9.2024 kërkuesi ka kërkuar edhe marrjen e një opinionit nga GJEDNJ-ja lidhur me kërkimin për shfuqizimin e dispozitave ligjore, me argumentin se përgjigja e asaj gjykate do të ndihmonte për sqarimin e çështjes në këtë drejtim. Në lidhje me këtë kërkesë Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi shqyrtimin e saj nga Gjykata në seancë plenare.

26. Në datën 3.10.2024 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përsheptimin e gjykimit të çështjes, me argumentin se ai ndodhej në paraburgim prej datës 27.7.2023, kur është ekzekutuar vendimi nr. 94/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, i lënë në fuqi me vendimin nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit. Në datën 7.10.2024 Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi pranimin e kërkesës, pasi gjykimi i shpejtë i çështjes ishte i nevojshëm në kushtet kur kërkuesi ndodhej në paraburgim për shkak të zbatimit të masës së sigurisë personale “Arresti në burg”.

27. Në parashtrimet e datës 30.9.2024 kërkuesi ka paraqitur edhe kërkesë për të mos u marrë në konsideratë, në cilësinë e provës, aktet e cituara në pikat 6, 8, 9 dhe 10 të “Listës së dokumenteve” bashkëlidhur prapësimeve të datës 16.9.2024 të Prokurorisë së Posaçme, me argumentet se këto prova nuk i përkasin objektit të këtij ankimi kushtetues individual, i cili bazohet në ankimin lidhur me procedurat e ndjekura dhe për vendimet e dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm deri në datën 22.12.2023. Sipas kërkuetit, këto akte të paraqitura nga organi i akuzës kanë të bëjnë me fazën përmbyllëse të hetimeve paraprake dhe ato duhet të përjashtohen nga shqyrtimi kushtetues.

28. Gjykata konstatoi se aktet e cituara në pikat 6, 8, 9 dhe 10 të “Listës së dokumenteve” bashkëlidhur prapësimeve të datës 16.9.2024 të Prokurorisë së Posaçme janë: “Vendimi i njoftimit të akuzës së të pandehurit Pëllumb Gjoka”, “Procesverbal deklarimi si person ndaj të cilit zhvillohen hetime i shtetasit Pëllumb Gjoka dhe procesverbal i pyetjes së tij si i pandehur”, “Njoftim për përfundimin e hetimeve të të pandehurit Pëllumb Gjoka”, “Procesverbal për deklarimin si person ndaj të cilit zhvillohen hetime i shtetasit Xh.L.”.

29. Po kështu, në aktin “Memorie dhe kërkesë” të datës 19.11.2024, kërkuesi ka paraqitur përpara Gjykatës kërkesën me objekt: 1) plotësimin e dosjes së formuar në Gjykatën Kushtetuese edhe me disa vendime dhe akte të GJEDNJ-së, Këshillit Kushtetues Francez dhe parlamentit shqiptar; 2) vlerësimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së në vendimin e datës 24.9.2024, për sa i përket analizës së dispozitave procedurale të legjislacionit francez për lejimin e kapjes së të dhënave të platformës së koduar “Enchrochat”, si dhe për paligjshmërinë e tyre lidhur me identifikimin e personave dhe përdorshmërinë e përmbajtjes së komunikimeve në proceset penale; 3) mbajtjen në konsideratë të faktit që ligjvënësi shqiptar refuzoi të përfshinte në përmbajtjen e KPP-së nenin 226/a “Marrja e të dhënave të komunikimeve” sipas projektligjit që u dorëzua në Kuvend në datën 28.12.2016.

30. Gjykata konstatoi se aktet e dërguara nga kërkuesi bashkëlidhur aktit “Memorie dhe kërkesë” të datës 19.11.2024 janë: (i) vendimi nr. 2022-987 QPC i datës 8.4.2022 i Këshillit Kushtetues Francez (në versionet shqip dhe frëngjisht); (ii) dosja e dokumenteve dhe komentari i vendimit nr. 2022-987 QPC i datës 8.4.2022 i Këshillit Kushtetues Francez (në versionet shqip dhe frëngjisht); (iii) vendimi për çështjen A.L. kundër Francës dhe E.J. kundër Francës, aplikimet nr. 44715/20 dhe nr. 47930/21, datë 24.9.2024 të GJEDNJ-së (në versionet shqip dhe frëngjisht); (iv) projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe relacioni bashkëlidhur tij, të protokolluar në Kuvend me nr. 3960 prot., datë 28.12.2016; (v) ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

31. Në seancën plenare të datës 19.12.2024 Gjykata mori në shqyrtim dy kërkesat e mësipërme të kërkuetit dhe duke mbajtur në konsideratë natyrën e pretendimeve të ngritura, si dhe natyrën e gjykimit kushtetues, vendosi të mos marrë parasysh kërkesën e tij për mosadministrimin e akteve shpresore të paraqitura nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, si edhe që të administrojë të gjitha provat

e paraqitura nga palët në këtë gjykim. Për sa i përket kërkesës për marrjen e një opinioni nga GJEDNJ-ja (*shih paragrafin 25 të vendimit*), Gjykata vendosi rrëzimin e saj, duke vlerësuar se këto opinione, për nga natyra e tyre, kanë natyrë këshillimore (*amicus curiae*) dhe se në çdo rast Gjykata arrin në përfundimin e saj në lidhje me çështjen mbi bazën e vlerësimit të pavarur të të gjitha fakteve dhe parashtrimeve e pretendimeve të palëve pjesëmarrëse në gjykimin kushtetues.

32. Po në seancë plenare Gjykata mori në shqyrtim edhe kërkesën e datës 2.12.2024 të paraqitur nga kërkuesi për bashkimin e çështjes në shqyrtim me atë që i përket ankimit kushtetues nr. 24 (P) 2024 të Regjistrisë Themeltar, datë 26.11.2024, me objekt kundërshtimin e vendimeve gjyqësore të dhëna në procesin gjyqësor për revokimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ose zëvendësimin e kësaj mase sigurimi me një masë tjetër më të butë. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata, bazuar në përmbajtjen e nenit 19, pika 2, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese vendosi të mos e pranojë atë, për sa kohë që këto çështje, edhe pse me kërkues të njëjtë, ndodhen në faza të ndryshme të shqyrtimit të tyre.

IV

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

33. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

34. Gjykata vëren se kërkuesi ka kërkuar në objektin e kërkesës si shfuqizimin e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, ashtu edhe të vendimeve gjyqësore që kanë caktuar ndaj tij masën e sigurimit personal “Arresti në burg”.

35. Për sa i përket kerkimit për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 6, pikat 1, shkronja “a” dhe “b” dhe 4, si dhe 42, pika 2, të ligjit nr. 95/2016, kërkuesi ka parashtruar se këto dispozita cenojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për shkak të mbikëqyrjes së vazhdueshme të komunikimeve elektronike të gjyqtarëve dhe familjarëve të tyre nga BKH-ja. Gjykata vëren se kushtetutshmëria e dispozitave të ligjit nr. 95/2016, që përcaktojnë kontrollin e plotë e periodik të të dhënave që përfshihen në konceptin e të dhënave private, i është nënshtruar më parë kontrollit kushtetues në drejtim të garancive që ofrojnë parimet e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjykatës, të sanksionuara në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata ka vlerësuar se regjimi i kontrollit periodik të komunikimeve të gjyqtarëve të gjykatave të posaçme autorizohet nga neni 135, pika 4, i Kushtetutës dhe se ligji nr. 95/2016 përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën se si realizohet kontrolli, pasi rezultatet e kontrollit eventual janë objekt vlerësimi nga gjykata në rastet e procedimit penal dhe nga KLGJ-ja në rastet e procedimeve disiplinore. Po sipas Gjykatës, kuadri ligjor në fuqi, që rregullon statusin e magjistratit dhe të drejtat që burojnë prej tij, përmban një tërësi garancish ligjore dhe procedurale shitesë, të cilat sigurojnë pavarësinë e gjyqtarëve të posaçëm në ushtrim të funksionit të tyre, ku përfshihet sistemi i emërimit, pagës, karrierës, shkarkimi dhe trajtimi i posaçëm i tyre (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, pasi vuri në diskutim pretendimet e kërkuesit në lidhje me këtë pjesë të objektit të kërkesës, konstatoi se ato janë, në thelb, të njëjta me ato të shqyrtuara më parë prej saj, ndaj çmoi se ndodhet përpara gjësë së gjykuar, për rrjedhojë nuk vijoi më tej me vlerësimin në themel të këtyre pretendimeve.

36. Për sa i përket kerkimit për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2,

të Kushtetutës, edhe në rastin e ankimeve kushtetuese individuale që kanë të bëjnë me masat e sigurimit personal, kërkuesi duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial. Kjo do të thotë se individ mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, si dhe të provojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi jo vetëm që ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, por edhe ka provuar se pasojat e pretenduara në lirinë personale kanë ardhur nga vendimet gjyqësore objekt kërkesë që kanë caktuar masën e sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj tij.

38. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata çmon se vendimet objekt kërkesë konsiderohen përfundimtare për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, bazuar në jurisprudencën e saj që i ka konsideruar të tilla vendimet për vendosjen e masave të sigurimit personal, për sa kohë prekin lirinë personale të individit dhe në situatën që janë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe janë shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur në lidhje me të drejtën e pretenduar si të cenuar (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 13.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Kriteri për shterimin e mjeteve nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 38, datë 12.7.2023; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata do të verifikojë, në drejtim të pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, nëse kërkuesi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit, pra nëse i ka ngritur ato paraprakisht përpara gjykatave të zakonshme.

40. Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në aspektin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi gjyqtarët e GJKKO-ve të Shkallës së Parë dhe Apelit kanë reflektuar njëanshmëri në gjykimin e çështjes, duke pranuar çdo kërkesë të Prokurorisë së Posaçme përpara dhe pas seancës për marrjen në pyetje të të arrestuarit, duke e paragjykuar atë, duke cenuar edhe *parimin e prezumimit të pafajësisë* dhe *të drejtën për t’u ankuar për ligjshmërinë e paraburgimit përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor*. Sipas kërkuetit, gjykatat e posaçme janë treguar të njëanshme, pasi nuk kanë trajtuar në baraspeshë kërkimet e Prokurorisë së Posaçme, me argumentet kundërshtuese të mbrojtësve ligjorë të tij dhe se paraburgimi i tij është vendosur *a priori*, bazuar në akte dhe prova që nuk janë shqyrtuar prej tyre, pasi nuk gjenden në fashikullin e gjykimit. Po sipas kërkuetit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka arsyetuar në lidhje me argumentet e mbrojtjes për papërdorshmërinë e komunikimeve të kryera në aplikacionin Sky ECC të marra nga autoritetet e huaja, ndërsa në arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit duket haptazi njëanshmëria e vlerësimit të provave, me qëllim justifikimin e mbajtjes së tij në paraburgim, në mënyrë arbitrare, duke lejuar edhe shtrembërimin e përmbajtjes së akteve të fashikullit të gjykimit ose zbatimin *a priori* dhe në mënyrë të njëanshme të primeve të një instrumenti të bashkëpunimit ndërkombëtar të paaplikueshëm në rastin në gjykim siç është Konventa Evropiane “Për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale”, e cila gjen zbatim ndërmjet vendeve të BE-së. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se këto argumente, në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, kërkuesi nuk i ka paraqitur më parë përpara gjykatave të zakonshme, por i ka parashtruar drejtpërdrejt në ankimin kushtetues. Po kështu, Gjykata vëren se edhe pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* kërkuesi nuk e ka ngritur as në ankimin drejtuar GJKKO-së së Apelit, as në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por e ka parashtruar në mënyrë të përgjithshme vetëm në aktin “Memorie” të datës 11.12.2023 të paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se në lidhje me këto pretendime kërkuesi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion.

41. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata konstaton se kërkuksi i ka ngritur më parë përpara gjykatave të zakonshme në formë dhe përmbajtje, duke përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

42. Kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 22.12.2023, i cili i është komunikuar mbrojtësit ligjor të kërkuksit nga Gjykata e Lartë me *email*-in e datës 26.3.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 7.5.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

43. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuksi i ka parashtruar pretendimet e tij në drejtim të *lirisë personale* sipas nenit 27 të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 1, të KEDNJ-së në këto aspekte: (i) *provat janë mbledhur në mënyrë të paligjshme*, sepse komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC janë përgjime ndaj përdorimi i tyre duhej verifikuar sipas rregullave të KPP-së; përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze është i padrejtuar, ndaj përbën përgjim masiv, që ndalohet nga ligji; përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze cenon sovranitetin shtetëror të Republikës së Shqipërisë; autoritetet shqiptare nuk kanë pasur autorizim nga autoritetet franceze për përdorimin e komunikimeve të kryera në aplikacionin Sky ECC në procesin penal; (ii) janë shkelur *parimet e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ndihmë të ndërsjellë në fushën penale” dhe dy protokolleve shtesë të saj*; (iii) nuk ka *dysshime të arsyeshme* se kërkuksi ka kryer vepra penale; (iv) është *cenuar e drejta për shqyrtim të shpejtë të ankimit ose për procedim në gjendje të lirë kundrejt garancisë pasurore*, e garantuar nga neni 28, pika 3, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3 dhe 4, i KEDNJ-së, për shkak se nuk i është garantuar e drejta për t’u ankuar përpara një autoriteti të pavarur gjyqësor, për të pasur kohën e nevojshme për të realizuar mbrojtjen dhe ankimin efektiv dhe për t’u liruar kundrejt garancisë pasurore; (v) është *cenuar e drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit, të garantuara* nga nenet 28, pika 2, 33, pika 1 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenet 5, paragrafi 3 dhe 6 të KEDNJ-së, sepse i është mohuar e drejta për të debatuar dhe kundërshtuar provat dhe mbrojtësit nuk janë njohur me aktet procedurale të përfuturit të komunikimeve të kryera në aplikacionin Sky ECC; (vi) është *cenuar e drejta për t’u dëgjuar nga gjykata*, e garantuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 5, paragrafi 3, i KEDNJ-së; (vii) është *cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

44. Për sa i përket *lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës* sipas nenit 36 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se kërkuksi nuk ka pretenduar cenimin e saj si një e drejtë e mëvetshme, në drejtim të respektimit të kriterëve të kufizimit sipas nenit 17 të Kushtetutës, por e ka parashtruar si argument të paligjshmërisë së marrjes së provës në kuadër të procedurës penale në formimin e dyshimit të arsyeshëm për caktimin e masës personale shtrënguese ndaj tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuksit në këtë drejtim do të trajtohet në suazën e dyshimit të arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale. Po kështu, në të njëjtin aspekt Gjykata do vlerësojë edhe argumentet e kërkuksit që lidhen me cenimin e parimit të sovranitetit të Republikës së Shqipërisë, për sa kohë që janë parashtruar në drejtim të pretendimit për ligjshmërinë e marrjes së provave mbi të cilat është mbështetur akuza penale.

45. Për sa i përket pretendimit të kërkuksit se letërporosia e dërguar nga pala shqiptare është bazuar në Konventën e Këshillit të Evropës, ndërkohë që pala franceze e ka ekzekutuar në bazë të Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1988, Gjykata nuk konstaton që një e metë e tillë do të ishte e aftë që të vinte në diskutim, në aspektin kushtetues respektimin e detyrimeve ndërkombëtare nga ana e autoriteteve shqiptare ashtu edhe marrëdhënien e bashkëpunimit mes autoriteteve shqiptare dhe atyre franceze.

46. Gjykata vëren, gjithashtu, se në parashtrimin e argumenteve të tij në mbështetje të pretendimit për cenimin e lirisë personale kërkuksi i është referuar edhe nenit 32, pika 2, të Kushtetutës, që parashikon të drejtën për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, ashtu edhe parimit të prezumimit të pafajësisë, që kërkon që kushdo të quhet i pafajshëm derisa t’i provohet fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata thekson se Kushtetuta lejon shprehimisht kufizimin e lirisë personale për shkak të interesit publik që lidhet me mbarëvajtjen e procedimit penal dhe dhënien e drejtësisë. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm jo vetëm justifikon në nivel kushtetues kufizimin e lirisë personale, por nuk rrezikon as parimin e prezumimit të pafajësisë në këtë fazë të procedimit penal. Për më tepër, dyshimi i arsyeshëm është shkaku për të cilin caktohet

masa e heqjes së lirisë në një procedurë gjyqësore që garanton elemente thelbësore të procesit të rregullt. Për rrjedhojë, edhe analiza e Gjykatës në rastin konkret do të fokusohet në verifikimin e dyshimit të arsyeshëm në kufizimin e lirisë personale të kërkuesit.

47. Gjykata thekson se liria personale ka dy aspekte: atë substancial, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedural, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata edhe në jurisprudencën e saj është shprehur se ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo sepse garancitë që ofron e drejta për proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, gjejnë zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi të lidhura me garancitë e parashikuara nga neni 28 i Kushtetutës dhe neni 5 i KEDNJ-së. Kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe se këto procedura duhet të sigurojnë garancitë e duhura (*shih vendimet nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 19, datë 4.4.2023*).

48. Në kuptim të sa më sipër, si dhe bazuar në natyrën dhe thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë pretendimet për cenimin e së drejtës substanciale të lirisë personale, si vijon: (a) *në aspektin procedural* pretendimet për: (i) *të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën e njohjes me dokumentacionin e dosjes gjyqësore dhe të drejtën e ankimit efektiv*; (ii) *të drejtën për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*; (iii) *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*; (b) *në aspektin substancial* pretendimet për: (i) *dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova*; (ii) *të drejtën për t'u proceduar në liri kundrejt garancisë pasurore*.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e lirisë personale

B.1.1 Për cenimin e lirisë personale në aspektin procedural

49. Gjykata çmon ta analizojë fillimisht lirinë personale në aspektin procedural, duke u ndaluar te analiza e pretendimeve të kërkuesit për cenimin e: a) *së drejtës së mbrojtjes të lidhur me të drejtën e ankimit efektiv dhe të drejtën e aksesit në dokumentacionin e dosjes*, si rrjedhojë e mos lejimit për të marrë kopje të akteve të dosjes gjyqësore dhe mosdhënies së kohës së nevojshme nga gjykatat për t'u njohur me dokumentet dhe aktet e dosjes gjyqësore; b) *së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, si rrjedhojë e moszbatimit të nenit 248 të KPP-së në seancën e marrjes në pyetje të kërkuesit në GJKKO-në e Shkallës së Parë dhe të Apelit, mospranimi të kërkesës për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore nga Gjykata e Lartë, si dhe moszhvillimit të debatit gjyqësor lidhur me aktet dhe provat e dosjes në seancat gjyqësore. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, për sa kohë që ai ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë trajtuar dhe u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të tij apo me mungesën e marrjes së një përgjigjeje të arsyetuar në lidhje me pretendimet e parashtruara përpara tyre, Gjykata vlerëson të mos e shqyrtojë si pretendim të mëvetshëm, por ta vlerësojë në kuadrin e trajtimit të secilit prej pretendime të lartpërmendura, duke verifikuar edhe mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në lidhje me to.

B.1.1.1 Për të drejtën e mbrojtjes të lidhur me të drejtën e njohjes me dokumentacionin e dosjes gjyqësore dhe të drejtën e ankimit efektiv

50. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit nuk i kanë dhënë kohë dhe lehtësi të mjaftueshme për të kundërshtuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal dhe përfaqësuesit e tij ligjorë nuk janë lejuar të njihen me aktet dhe provat mbi të cilat ai është privuar nga liria. Sipas kërkuesit, GJKKO-të e Shkallës së Parë dhe të Apelit kanë cenuar të drejtën e tij për njohjen dhe marrjen e kopjeve të transkripteve dhe të akteve procedurale në bazë të së cilave është lejuar përgjimi dhe mbrojtësit e tij, jo vetëm nuk u njoftuan në kohë për seancën për marrje në pyetje

të të arrestuarit, por as nuk u lejuan gjatë zhvillimit të kësaj seance që të njiheshin në mënyrë efektive me përmbajtjen e akteve të dosjes hetimore, duke u pranuar kërkesa e prokurorisë. Njohja me aktet e dosjes, ka pretenduar kërkuesi, ka qenë vetëm vizuale dhe gjykata ka kërkuar nga mbrojtësit e tij nënshkrimin e një deklarate përgjegjësie, si dhe ka urdhëruar dorëzimin në sekretari të mjeteve të shkrimit, që ata të mos mbanin asnjë shënim. Kërkuesi ka pretenduar se GJKKO-ja e Apelit, jo vetëm nuk pranoi kërkesën për njohjen e plotë të akteve dhe provave, por kufizoi kohën e mbrojtësve për të studiuar përmbajtjen voluminoze të fashikullit gjyqësor. Sipas kërkuetit, ndonëse kërkesa e mbrojtësve u dorëzua në datën 23.8.2023, mundësia për t'u njohur me fashikullin e gjykimit iu dha vetëm disa orë para zhvillimit të seancës gjyqësore. Sipas kërkuetit, edhe Prokuroria e Posaçme refuzoi t'i përgjigjej kërkesës me shkrim të datës 29.8.2023 të mbrojtësve ligjorë për njohjen me aktet e dosjes hetimore dhe provat, duke cenuar të drejtën për të ushtruar ankim efektiv në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit nuk i korrigjoi këto shkelje dhe ndonëse pranoi pjesërisht kërkesën, duke lejuar mbrojtësit ligjorë të njiheshin dhe të studionin vetëm përmbajtjen e akteve procedurale të çështjes, nuk lejoi marrjen e kopjeve të njësuara me origjinalin të akteve procedurale të autoritetit gjyqësor të huaj. Sipas kërkuetit, vetëm pas paraqitjes së kërkesës së datës 15.5.2024 nga mbrojtësit e tij ligjorë, gjyqtarja e seancës paraprahe i ka lejuar ata të njihen plotësisht me dosjen hetimore dhe të marrin kopje të njësuara me origjinalin të disa prej akteve dhe provave të saj. Mungesa e aktit "Informacion" të Europol-it, sipas kërkuetit, e ka penguar atë për të njohur përmbajtjen e tij dhe mënyrën e regjistrimit të procedimit penal nr. 41/2023. Kërkuesi ka pretenduar se ky akt është shmangur tërësisht nga debati gjyqësor dhe gjykatat nuk i kanë dhënë mundësi të njihet me të, duke u pajtuar me vlerësimin e organit të akuzës për mbajtjen sekret të përmbajtjes së këtij akti. Po sipas kërkuetit, edhe vendimet gjyqësore të autorizimit të përgjimeve dhe lejimit të zgjatjes së afateve të tyre nuk janë dorëzuar nga Prokuroria e Posaçme as në Gjykatën e Lartë deri në datën 22.12.2023, kur është shqyrtuar rekursi i tij.

51. Sipas subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, ky pretendim është i pabazuar, pasi nga aktet e fshikullit gjyqësor rezulton se në momentin e ekzekutimit të masës së sigurimit kërkuetit i është vënë në dispozicion kopje e vendimit gjyqësor për caktimin e saj. Sipas këtij subjekti, masa e sigurimit është ekzekutuar në datën 27.7.2023 dhe sipas nenit 248 të KPP-së është proceduar me marrjen në pyetje të kërkuetit dhe verifikimin e kushteve të ekzekutimit të masës së sigurimit brenda 3 ditëve. Sipas tij, nga dita e ekzekutimit të masës së sigurimit deri në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023 nuk është paraqitur asnjë kërkesë për t'u njohur me aktet dhe provat. Në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023 avokatët e kërkuetit kërquan kohë që të njiheshin dhe të merrnin akte dhe prova që gjendeshin në fashikullin e caktimit të masës së sigurimit dhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme shprehën dakordësinë e tyre që mbrojtësit e kërkuetit të njiheshin me aktet dhe provat, por jo të merrnin kopje të tyre në këtë fazë të hetimit, pasi ishte nxjerrë urdhri për ruajtjen e sekretit hetimor i datës 21.7.2023 i prokurorëve të çështjes. Subjekti i interesuar ka prapësuar se GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 28.8.2023, ka pranuar kërkesën e mbrojtësve të kërkuetit për t'u njohur me aktet e provat e fashikullit, duke u dhënë kohë të arsyeshme për këtë qëllim, fakt ky i pranuar gjatë gjykimit në apel nga njëri prej mbrojtësve. Kërkuesi, në mënyrë abuzive, ka pretenduar se nuk është njohur me aktet e provat që kanë shërbyer për caktimin e masës së sigurimit, ndërkohë që duke iu referuar ankimit dhe rekursit rezulton se ato janë hartuar në mënyrë të detajuar, vetëm pasi mbrojtësit ligjorë të tij janë njohur me vendimet gjyqësore dhe provat mbi të cilat janë mbështetur gjykatat e faktit. Sipas këtij subjekti të interesuar, gjatë hetimeve paraprahe dhe sidomos në momentin e përfundimit të tyre, kërkuesi është njohur me çdo akt dhe provë të grumbulluar gjatë kësaj faze, ku përfshihen jo vetëm aktet e ardhura me letërporosi, por edhe provat shkresore, shkencore, akte ekspertimi, deklarime të personave që kanë dijeni gjatë fazës së hetimit paraparak etj. Subjekti i interesuar ka prapësuar se kërkuesi është marrë në pyetje me qëllim sqarimin e pozitës së tij dhe qëndrimin në raport me akuzën dhe në këtë çështje kanë ekzistuar të gjithë garancitë, pasi autorizimi për përgjimin në Francë është dhënë nga një autoritet gjyqësor, sikurse është gjyqtari hetues. Po sipas këtij subjekti, individit ka akses në këto të dhëna pasi ato bëhen publike në procedimin e filluar kundër tij (pasi zbatohet masa e sigurimit ose ushtrohet kontroll) dhe ligjshmëria e përgjimit mund të kundërshtohet përpara autoriteteve gjyqësore, sikundër në rastin konkret është bërë objekt gjykimi përpara të gjitha shkallëve të gjyqësorit.

52. Gjykata vëren se të drejtat dhe garancitë e personit të cilit i hiqet liria janë parashikuar në nenet 28 dhe 31 të Kushtetutës, ku neni 28 garanton, mes të tjerash, të drejtat: për t'u njoftuar menjëherë për shkaqet e masës dhe akuzën; për të komunikuar menjëherë me avokatin dhe për t'u dhënë mundësia për realizimin e të drejtave; për t'u dërguar brenda 48 orëve, në rastet e heqjes së lirisë, sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi "c", të Kushtetutës, përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirim jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim; për t'u ankuar kundër vendimit të gjyqtarit; për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm ose për t'u proceduar i lirë përkundërt një garancie pasurore sipas ligjit; e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit. Për sa i përket nenit 31, ai garanton, mes të tjerash, të drejtën për të pasur kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen (shkronja "b"), ashtu edhe të drejtën për t'u mbrojtur vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, si dhe për të komunikuar lirisht dhe privatisht me të (shkronja "ç").

53. Gjykata vëren se të drejtat e parashikuara në nenin 31 të Kushtetutës janë në funksion të së drejtës së mbrojtjes, si një nga garancitë themelore për realizimin e së drejtës për një proces të rregullt, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, i cili, sikurse u theksua edhe më sipër (*shih me sipër paragrafin 47 të vendimit*) gjen zbatim edhe në proceset gjyqësore që vendosin për kufizimin e lirisë personale. Ashtu siç është pohuar në jurisprudencën e Gjykatës, veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishme e thelbësore të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 83, datë 30.12.2016; nr. 49, datë 10.7.2015; nr. 19, datë 18.9.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket së drejtës së ankimit, ajo është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial (*shih vendimet nr. 2, datë 18.1.2017; nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Gjykata, duke pasur parasysh standardet e mësipërme dhe thelbin e pretendimeve të kërkuarit të lidhura me të drejtën e njohjes me dokumentet e dosjes vlerëson t'i shqyrtojë pretendimet e tij në drejtim të garantimit të: i) aksesit në aktet e dosjes; ii) kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes efektive; iii) ankimit efektiv në gjykatë.

55. *Lidhur me pretendimin për aksesin në aktet e dosjes*, Gjykata vëren se sipas GJEDNJ-së e drejta për të disponuar provat përkatëse nuk është një e drejtë absolute, pasi në një procedim penal mund të ketë interesa konkurrues, siç janë: siguria kombëtare ose nevoja për të mbajtur sekret metoda të policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të priorizohen kundërt të drejtave të të akuzuarit (*shih Jaspar kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM]nr. 27052/95, datë 16 shkurt 2000, § 52*). Në disa raste mund të jetë e nevojshme që mbrojtjes të mos i vihen në dispozicion disa prova për të ruajtur të drejtat themelore të një individi tjetër ose për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik. Në vlerësimin e garancive përkatëse procedurale, Gjykata duhet të ketë parasysh rëndësinë e materialit të pazbuluar dhe përdorimin e tij në gjykim (*shih Yuksel Yalcinkaya kundër Turqisë nr. 15699/20, datë 23 shtator 2023, § 71*).

56. Gjykata e Kasacionit e Mbretërisë së Belgjikës në një gjykim që lidhej me aplikacionin Sky ECC ka pranuar se aksesin në dokumentacionin e dosjes hetimore lidhej me të drejtën e mbrojtjes dhe atë të ankimit efektiv. Kjo kërkon që mbrojtja të ketë akses në të gjitha elementet inkriminuese ashtu edhe shfaqësuese të dosjes. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe mund t'u nënshtrohet kufizimeve, duke përfshirë edhe fazën e shqyrtimit nga gjyqtari hetues, pasi të dhënat e marra nga dosja mund të jenë ende pjesë e një hetimi në vazhdim dhe në kushtet e mbrojtjes së sekretit hetimor. Natyra sekrete e hetimit në dosjen Sky ECC mund të shfrytëzohet aktualisht për të mos i bërë ende të njohur kërkuarit gjithë informacionin e disponueshëm (*shih vendimin e Gjykatës së Kasacionit të Mbretërisë së Belgjikës, P.0019N/322, datë 11 janar 2022*).

57. Në nenin 105, pikat 1 dhe 2, të KPP-së parashikohet se gjatë procedimit dhe pas përfundimit të tij, cildo që ka interes mund të marrë, me shpenzimet e veta, kopje, ekstrakte ose vërtetime të akteve të veçanta apo të regjistrimeve audio ose audiovizive. Kërkesa shqyrtohet nga prokurori, për aktet e hetimit paraprak, ose nga gjykata që ka dhënë vendimin për ato të shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 279, pika 1, të KPP-së, aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në

rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve. Sipas nenit 246, pika 1, të KPP-së oficeri ose agjenti i policisë i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit dhe e njëh menjëherë me letërën e të drejtave, sipas paragrafit 2 të nenit 34/b të tij. Policia Gjyqësore mban procesverbal për veprimet e kryera dhe procesverbali i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit.

58. Gjykata konstaton se me urdhrin e datës 21.7.2023 të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme është urdhëruar ruajtja e sekretit hetimor për disa nga aktet e administruara në kuadër të këtij procedimi penal deri në përfundim të hetimeve paraprake, për shkak se njohja e personave nën hetim me këto akte do të zbulonte sekretin hetimor dhe identitetin e personave të tjerë të përfshirë në aktivitete të paligjshme kriminale, si dhe nuk do të bënte të mundur kryerjen e veprimeve të tjera hetimore. Pas ekzekutimit në datën 27.7.2023 të masës së sigurimit personal “Arresti në burg” të caktuar për kërkuesin, bazuar në nenin 248 të KPP-së, brenda afatit ligjor treditör, është proceduar me marrjen e tij në pyetje dhe verifikimin e kushteve të ekzekutimit të kësaj mase. Nga kjo datë dhe deri në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023 për marrjen në pyetje të kërkuesit, mbrojtësit ligjorë të tij nuk kanë paraqitur asnjë kërkesë për t’u njohur me aktet e fashikullit hetimor.

59. Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 29.7.2023 të zhvilluar në GJKKO-në e Shkallës së Parë për marrjen në pyetje të kërkuesit dhe vlefhtësimin e masës së sigurimit personal, rezulton se ajo gjykatë u ka dhënë mundësinë mbrojtësve ligjorë të kërkuesit për t’u njohur me aktet e fashikullit gjyqësor, edhe pse nuk i ka lejuar të marrin kopje të tyre, për shkak të zbatimit të urdhrit për ruajtjen e sekretit hetimor të datës 21.7.2023 të Prokurorisë së Posaçme, i cili kufizonte aksesin e tyre në disa nga aktet e fashikullit hetimor, ku përfshihen edhe procesverbale të BKH-së me komunikimet e marra në aplikacionin Sky ECC që përfshijnë edhe persona të tjerë nën hetim.

60. Përpara zhvillimit të seancës për shqyrtimin e ankimit ndaj masës së sigurimit, me kërkesën e datës 23.8.2023 përfaqësuesit e kërkuesit kanë kërkuar njohjen me aktet e dosjes dhe marrjen e kopjeve të akteve të saj. GJKKO-ja e Apelit, me urdhrin e datës 28.8.2023, ka vendosur të pranojë kërkesën e mbrojtësve ligjorë të kërkuesit për njohjen e plotë të akteve të dosjes gjyqësore, si dhe ka rrëzuar kërkesën për marrjen e kopjeve të njehsuara me origjinalin të akteve të kërkuara, me argumentin se neni 105, pika 2, i KPP-së ia njeh prokurorit të posaçëm të çështjes kompetencën për të vendosur për marrjen e akteve të hetimit paraprak të procedimit (*shih fagen 3 të urdhrit të datës 28.8.2023 të GJKKO-së së Apelit*). Po kështu, gjatë shqyrtimit të ankimit për masën e sigurimit ndaj kërkuesit, GJKKO-ja e Apelit ka marrë në shqyrtim edhe pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes efektive në shkallë të parë dhe e ka gjetur të pabazuar atë, duke argumentuar se nga mbrojtësit ligjorë të kërkuesit është kërkuar njohja me aktet e dosjes mbi të cilat prokurorët e posaçëm mbështesnin kërkesën për masën e sigurimit vetëm në seancën e marrjes në pyetje të personave të arrestuar, e cila u është vënë në dispozicion nga gjykata brenda parashikimit të nenit 248, pika 1, të KPP-së, fakt që evidentohet në procesverbalin e seancës së datës 29.7.2023, ku gjyqtari i hetimeve paraprake, pas kërkesës së mbrojtësve të kërkuesit, ka urdhëruar ndërprerjen e seancës gjyqësore me qëllim dhënien e kohës së nevojshme për t’u njohur me aktet e fashikullit gjyqësor. Sipas GJKKO-së së Apelit, neni 105 i KPP-së i jep të drejtën kërkuesit që të paraqesë kërkesa në lidhje me aktet e hetimit paraprak përpara prokurorit, i cili ka kompetencën dhe autoritetin për të vendosur lidhur me to. Ndërkohë që nuk rezultonte as nga aktet, por nuk pretendohet as nga mbrojtësit ligjorë të kërkuesit, që të ishin paraqitur kërkesa të tilla përpara prokurorëve të posaçëm. Në vijim, GJKKO-ja e Apelit ka dalë në përfundimin se në kushtet kur mbrojtësit ligjorë të kërkuesit nuk kanë paraqitur kërkesë për këtë qëllim përpara prokurorëve të posaçëm përpara zhvillimit të seancës për marrje në pyetje, si dhe në kushtet kur pas paraqitjes së kërkesës për njohje me aktet përpara gjyqtarit të seancës paraprake përfaqësuesit e kërkuesve janë njohur me to, ata nuk mund të ankohen se u ka munguar njohja me ato akte (*shih fagen 12 të vendimit nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit*). Gjykata e Lartë ka vlerësuar se GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar mjaftueshëm dhe në mënyrë shteruese për të gjitha pretendimet që mbrojtja e të hetuarve ka ngritur në ankim (*shih paragrafin 112 të vendimit nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

61. Gjykata vëren se, sipas procesverbalit të Prokurorisë së Posaçme të datës 27.7.2023 “Për ekzekutimin e masës së sigurisë për shtetasin Pëllumb Gjoka”, kërkuksi ka rënë në dijeni të së drejtës për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes hetimore që në momentin e njoftimit të vendimit për caktimin e kësaj mase, moment nga i cili i kanë lindur të gjitha të drejtat dhe garancitë procedurale të parashikuara nga neni 34/b i KPP-së, gjë që provohet nga marrja dijeni sipas letrës së të drejtave të të arrestuarit/ndaluarit, e nënshkruar prej tij. Bazuar në nenin 105 të KPP-së, mbrojtësit e kërkuksit kanë pasur të gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur kërkesë për t’u njohur me provat dhe dokumentet në fashikullin hetimor në Prokurorinë e Posaçme që në fazën e hetimeve paraprake dhe të shfrytëzuarin kohën në dispozicion. Në këtë kuptim, ka qenë zgjedhja e tyre që të paraqisnin kërkesë për njohjen me aktet e dosjes në një fazë të mëvonshme, gjatë gjykimit për vlerësimin e vazhdimin të masës së sigurimit personal dhe ankimit ndaj saj në gjykatat më të larta.

62. Gjykata vëren se pretendimet e kërkuksit në drejtim të aksesit në aktet e dosjes, të lidhur me ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes, janë fokusuar në këto aspekte: i) njohja vizuale me ato akte; ii) moslejimi i përfaqësuesve të tij për mbajtjen e shënimeve; iii) mospajisja me kopje të njësuara me origjinalet e akteve; iv) mosnjohja fare me aktin “Informacion”. Për sa i përket së drejtës së mbrojtjes Gjykata, bazuar në standardet e mësipërme (*shih paragrafët 47 dhe 53 të vendimit*), thekson se ajo nuk është absolute dhe se mund të kufizohet për sa kohë që në një procedim penal mund të ndërhyjnë interesa konkurruese me të drejtat e të akuzuarit në procesin penal, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe mbrojtja e sekretit të metodave të hetimit, mbrojtja e të drejtave themelore të individëve të tjerë apo mbrojtja e një interesi të rëndësishëm publik. Megjithatë, ky kufizim nuk mund të jetë i tillë që të vërë në rrezik vetë thelbin e kësaj të drejte, çka do të çonte deri në mohimin e saj. Në këtë kuptim, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, aksesit në dokumentacion nënkupton të gjitha aktet mbi të cilat është bazuar dyshimi i arsyeshëm që ka justifikuar caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuksit, që përfshin si standard minimal njohjen me to dhe mbajtjen e shënimeve mbi përmbajtjen e këtyre akteve, edhe në ato raste përjashtimore kur aksesit përmes marrjes së kopjeve të këtyre akteve është kufizuar, siç është rasti konkret, me urdhrin e prokurorëve të posaçëm, të nxjerrë në bazë të ligjit procedural penal, për ruajtjen e sekretit të hetimit.

63. Kërkesat që lejojnë kufizimin e marrjes së kopjeve të njësuara të akteve, nuk janë të tilla që të justifikojnë edhe kufizimin e së drejtës për t’u njohur me ato akte dhe për të mbajtur shënime mbi to, përndryshe e drejta e mbrojtjes do të ishte iluzore dhe formale.

64. Për sa më lart, Gjykata vëren se, në rastin konkret, sjellja e gjykatave të zakonshme që edhe pse i kanë lejuar përfaqësuesit e kërkuksit të njihen vetëm vizualisht me aktet e dosjes, nuk i kanë lejuar të mbajnë shënime në lidhje me to, përbën cenim të aksesit në ato akte, në këndvështrim të së drejtës së mbrojtjes. Megjithatë, duke pasur parasysh se e drejta e mbrojtjes efektive është në funksion të së drejtës së ankimit efektiv në gjykatë, Gjykata arrin në përfundimin se kjo shkelje nuk ka cenuar vetë thelbin e së drejtës së kërkuksit për t’u mbrojtur në këtë fazë të procedurës, për sa kohë që kërkuksi ka ushtruar, përmes përfaqësuesve të tij, të drejtën e ankimit në gjykatë, çka konsiderohet se përbën një rekuperim të kësaj shkeljeje në këtë procedurë në tërësinë e saj. Po ashtu, Gjykata arrin në përfundimin se edhe mospajisja e kërkuksit dhe mbrojtësve të tij me kopje të njësuara të akteve prej gjykatave që kanë vendosur për masën e sigurimit nuk ka cenuar të drejtën e njohjes me aktet në funksion të së drejtës së mbrojtjes të lidhur me atë për të paraqitur ankim. Gjithashtu, Gjykata, duke pasur parasysh garancitë e zbatueshme në këtë fazë të procedimit, e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin e kërkuksit për mosnjohjen me aktin “Informacion” të Europol-it, për shkak se ai mungon në dosje ndaj i është shmangur debatit gjyqësor. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Gjykata mban parasysh se ky akt nuk iu nënshtrua njohjes nga mbrojtësit e kërkuksit pasi ai (akti) përmbante të dhëna edhe për persona të tjerë për të cilët zhvilloheshin hetime. Megjithatë akti “Informacion” nuk rezulton të jetë përdorur si bazë për formimin e dyshimit të arsyeshëm ndaj kërkuksit në caktimin e masës së sigurimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuksit në drejtim të mungesës së aksesit në aktet e dosjes është i pabazuar.

65. Për sa i përket pasjes së kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes efektive, Gjykata vëren se afatet e shpejta të vendimmarrjes në rastet e heqjes së lirisë së individit imponohen, në radhë të parë, nga neni 28 i Kushtetutës dhe, në vijim, nga përmbajtja e neneve 248, pika 3 dhe 249 të KPP-së, si garanci

procedurale në favor të individit. Gjykata konstaton se masa e sigurimit “Arresti në burg”, e caktuar ndaj kërkuesit me vendim të GJKKO-së së Shkallës së Parë, është ekzekutuar në datën 27.7.2023 dhe vlerësimi i ligjshmërisë së saj është bërë nga gjykata brenda 48 orëve, në datën 29.7.2023, në prani të kërkuesit dhe mbrojtësve të tij. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të marrjes në pyetje të personit nën hetim të datës 29.7.2023, rezulton se gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore në GJKKO-në e Shkallës së Parë mbrojtësit ligjorë të kërkuesit kanë kërkuar kohë për t’u njohur me materialet e çështjes, çka rezulton të jetë pranuar nga gjykata, e cila ka vendosur shtyrjen me 1 orë e 30 minuta të seancës, ndërkohë që edhe GJKKO-ja e Apelit, me vendimin e datës 28.8.2023, ka pranuar kërkesën e mbrojtësve të kërkuesit për t’u njohur me aktet e provat e fashikullit, duke u dhënë kohë të arsyeshme për këtë qëllim. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar, gjithashtu, se edhe koha e ofruar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë për qëllime të realizimit të mbrojtjes ka qenë e mjaftueshme sipas parashikimit të nenit 248, pika 1, të KPP-së dhe një fakt i tillë reflektohet qartësisht në procesverbalin e seancës gjyqësore së datës 29.7.2023, kur, pas kërkesës së mbrojtësve ligjorë të kërkuesit, gjyqtari i hetimeve paraprake ka urdhëruar ndërprerjen e seancës, me qëllim dhënien e kohës së nevojshme, për atë që lejonte parashikimi i nenit 248, pika 1, të KPP-së në kombinim me parashikimin e nenit 261, pika 2, të KPP-së (*shih fagen 12 të vendimit nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit*).

66. Gjykata, bazuar në sa më sipër, si edhe në përfundimet e saj në lidhje me pretendimin për cenimin e aksesit në aktet e dosjes, në drejtim të *kohës së nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes* vlerëson se përfaqësuesit e kërkuesit nuk rezulton të jenë vënë në pamundësi për të përgatitur mbrojtjen e tij, për sa kohë që jo vetëm kërkuesi është vënë në dijeni të të drejtave të tij që në momentin e njoftimit të vendimit të masës së arrestit, por edhe gjykatat, bazuar në kërkesat e mbrojtësve të kërkuesit, kanë marrë të gjitha masat për të siguruar në kohën dhe formën e duhur njohjen e tyre me aktet e dosjes që i përkasin kërkuesit, pikërisht në funksion të respektimit të kësaj garancie procedurale. Gjykata rithekson qëndrimin e saj se mënyra se si mbrojtësit zgjedhin të realizojnë mbrojtjen mbetet çështje e strategjisë së mbrojtjes të ndërtuar mes tyre e kërkuesit dhe i përket ushtrimit apo jo të të drejtave dhe garancive procedurale, bazuar në udhëzimet dhe marrëdhënien me të përfaqësuarin, çka në thelb përcakton sjelljen e avokatit (*shih vendimet nr. 45, datë 3.10.2023; nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 1.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës dhe përmbajtjen e vendimeve gjyqësore, nuk konstaton që mbrojtja e ofruar nga mbrojtësit e kërkuesit të ketë qenë joefektive, për sa kohë që ata rezulton të kenë parashtruar përpara gjykatave edhe pretendime që kanë të bëjnë me përmbajtjen e akteve të procedimit penal, përfshirë edhe lidhjen e kërkuesit me kodin pin të atribuar apo përmbajtjen komunikimeve të kryera në aplikacionin Sky ECC. Për rrjedhojë, Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin në drejtim të kohës së pamjaftueshme për njohjen me aktet e procedimit penal.

67. Për sa i përket pretendimit për të drejtën e ankimit efektiv në gjykatë, bazuar në gjetjet dhe konsideratat e mësipërme, Gjykata vlerëson se mbrojtësit e kërkuesit nuk janë vënë efektivisht në pamundësi për të paraqitur ankim. Kërkuesi jo vetëm që e ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta në aspektin formal, duke paraqitur, përmes përfaqësuesve të tij, ankim në GJKKO-në e Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë, por edhe në aspektin substancial të saj, duke u bazuar edhe në të dhënat e akteve të procedimit penal me të cilat mbrojtësit ligjorë janë njohur përgjatë këtij procesi, ka ngritur përpara atyre gjykatave, të gjitha pretendimet në drejtim të dyshimit të arsyeshëm për përfshirjen e tij në kryerjen e veprave penale që i atribuohen, duke marrë edhe përgjigje nga ato gjykata në lidhje me shkaqet e këtyre ankimeve.

68. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes të lidhur me të drejtën e aksesit në dosje dhe të drejtën e ankimit efektiv janë të pabazuara.

B.1.1.2 Për të drejtën për t’u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

69. Sipas kërkuesit, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka shkelur detyrimet e saj për të verifikuar në seancë gjyqësore, në prani të palëve, përmbajtjen e provave në bazë të së cilave ka pranuar kërkesën e Prokurorisë së Posaçme për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”. Kërkuesi ka pretenduar se gjykimi është zhvilluar në mungesë të debatit gjyqësor lidhur me provat dhe aktet që nuk u paraqitën në seancë gjyqësore për shkak të urdhrit për ruajtjen e sekretit hetimor dhe se vetëm prokurori ka pasur akses në provat e dërguara me letërporsinë e autoriteteve të drejtësisë franceze. Sipas tij, edhe

GJKKO-ja e Apelit ka përkrahur qasjen e GJKKO-së së Shkallës së Parë duke mos lejuar paraqitjen dhe verifikimin e provave dhe akteve të fashikullit gjyqësor në seancën gjyqësore të datës 29.8.2023, si dhe debatin e palëve lidhur me to, ndërkohë që edhe mospranimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve nuk ka lejuar zhvillimin e debatit mes palëve. Sipas kërkesit, në fashikullin hetimor mungojnë edhe procesverbalet e certifikimit të vërtetësisë së deshifrimit të komunikimeve të enkriptuara, procesverbalet e këqyrjes, kontrollit dhe sekuestros provuese për serverët e platformës Sky ECC dhe në volumin e ri hetimor të Prokurorisë së Posaçme nuk gjenden as letërporosia e datës 14.2.2024, as ajo e ekzekutuar nga autoriteti gjyqësor francez, si dhe kushtet për përdorimin e transkripteve dhe të provave të tjera. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, pasi GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk e ka përmbytur detyrimin e parashikuar në nenin 248 të KPP-së për marrjen e tij në pyetje. Sipas tij, kjo shkelje provohet përmes procesverbalit të seancës gjyqësore, ku atij i është kërkuar të deklaronte vetëm gjeneralitetet, edhe pse e drejta e të arrestuarit që të dëgjohet për versionin e tij kundër kërkesës së akuzës përbën një të drejtë të garantuar nga neni 28, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 5, pika 3, i KEDNJ-së. Kjo e drejtë, sipas kërkesit, është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila nuk ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe për ta dëgjuar atë.

70. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimet e kërkesit janë të pabazuara. Në drejtim të pretendimit për të drejtën për të debatuar dhe kundërshtuar provat, në seancën gjyqësore të datës 29.7.2023, me objekt marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të masës së sigurimit, kërkesi, nëpërmjet mbrojtësve të tij, ka parashtruar argumente për kundërshtimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme dhe rrëzimin e saj lidhur me masën e sigurimit personal, ka paraqitur kërkesat e tij para gjykatës, si dhe provat shkresore që i ka çmuar të nevojshme dhe pretendimet e tij janë kundërshtuar edhe nga përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme, duke iu nënshtruar debatit gjyqësor. Sipas këtij subjekti, GJKKO-ja e Apelit, pas debatit gjyqësor, ka marrë në shqyrtim dhe u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkesit. Subjekti i interesuar ka prapësuar se nuk rezulton që gjykatat e faktit të kenë vënë kërkesin në pozita të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, për sa kohë që i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e tij dhe u kanë dhënë atyre përgjigje të arsyetuar. Sipas subjektit të interesuar, i pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, pasi, në kundërshtim me sa pretendohet, nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 29.7.2023 evidentohet se GJKKO-ja e Shkallës së Parë ia ka dhënë fjalën kërkesit dhe ai është shprehur lidhur me akuzën. Po kështu, sipas këtij subjekti, gjatë fazës së hetimeve paraprake kërkesi është pyetur në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 11.9.2023 dhe në cilësinë e të pandehurit në datën 25.4.2024, duke iu dhënë mundësi të japë shpjegime në lidhje me faktet penale për të cilat akuzohet.

71. Gjykata, duke pasur parasysh garancitë dhe standardet e së drejtës së mbrojtjes që gjejnë zbatim në këtë fazë të procedimit, si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt (*shih paragrafët 47 dhe 53 të vendimit*) thekson se një ndër qëllimet e nenit 28, pika 2, të Kushtetutës është edhe garantimi i së drejtës së personit të cilit i është kufizuar liria personale për t'u dëgjuar nga gjykata në lidhje me pretendimet e tij, si dhe për t'u mbrojtur ndaj çdo kufizimi të padrejtë e arbitrar të kësaj lirie. E drejta e personit që i hiqet liria për vlerësim gjyqësor të ligjshmërisë së masës së ndalimit parashikohet, gjithashtu, në nenin 5, pika 4, të KEDNJ-së. Në jurisprudencën e saj GJEDNJ-ja ka theksuar se kjo e drejtë, e cila përbën edhe *habeas corpus*-in e KEDNJ-së, qëndron në thelb të garancive që ofron neni 5, pika 4, i KEDNJ-së. Një person i arrestuar ose i ndaluar ka të drejtën e shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së masës, nën dritën jo vetëm të kërkesave ligjore kombëtare, por, gjithashtu, dhe të KEDNJ-së, parimeve të përgjithshme të shprehura në të dhe qëllimit të kufizimeve të lejuara nga paragrafi 1 i nenit 5. Shqyrtimi duhet të shtrihet mbi ato kritere të cilat janë thelbësore për vlerësimin e ligjshmërisë, sipas llojit të masës së caktuar, si dhe duhet të garantojë parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i dhënë të ndaluarit mundësi efektive për të kundërshtuar dyshimet ose akuzat ndaj tij (*shih vendimin nr. 83, datë 5.12.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se mundësia që një i ndaluar të dëgjohet personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi është një nga garancitë themelore të procesit (*shih Kampanis kundër Greqisë, 1995, § 47*), proces i cili duhet të jetë kontradiktor dhe të garantojë “barazinë e armëve” ndërmjet palëve (*shih Reinprecht kundër Austrisë, 2005, § 31; A. dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], 2009, § 204*).

72. Bazuar në parashikimet e neneve 28 dhe 42 të Kushtetutës, ndonëse neni 244 i KPP-së ka parashikuar se masa e sigurimit vendoset nga gjykata mbi bazën e kërkesës së arsyetuar të prokurorit dhe vendimi merret në dhomën e këshillimit, neni 248 i KPP-së parashikon marrjen në pyetje nga gjykata, të personit për të cilin ka vendosur arrestin në burg ose në shtëpi, jo më vonë se tri ditë nga zbatimi i asaj mase.

73. Në kuadër të parashikimeve kushtetuese e ligjore dhe jurisprudencës së mësipërme kushtetuese, Gjykata do të analizojë në vijim pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u marrë në pyetje, duke u ndaluar fillimisht në analizën nëse është respektuar parashikimi i nenit 28, pika 2, të Kushtetutës lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar përpara gjyqtarit. Po kështu, Gjykata, në aspektin e së drejtës për t'u dëgjuar të lidhur me parimin e barazisë së armëve, do të analizojë nëse kërkuarit, duke pasur parasysh këtë fazë të procedurës, i janë krijuar kushtet për të bërë deklaratime dhe për të kundërshtuar dyshimet e arsyeshme të atribuara nga prokurori, si dhe nëse pretendimet e tij kanë marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme.

74. Gjykata vlerëson të theksojë, fillimisht, se edhe pse procedurat gjyqësore që lidhen me masat e sigurimit, veçanërisht ato të arrestit, duhet të sigurojnë garancitë e duhura për individin, për sa u përket garancive të së drejtës për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, ato nuk janë absolute dhe nuk zbatohen në të njëjtën mënyrë si në procesin gjyqësor të themelit të çështjes. Kjo sepse kufijtë e përcaktuar nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja në parashikimin e garancive të posaçme në rastin e kufizimit të lirisë, që imponojnë afate të shpejta dhe më të shkurtra kohore për shqyrtimin e kërkesës për caktimin e këtyre masave të sigurimit, pasjellin edhe kufizimin e disa prej garancive që imponon neni 42 i Kushtetutës, veçanërisht në drejtëm të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parim i cili nuk zbatohet në të njëjtën masë dhe mënyrë si në gjykimin e themelit për sa i përket debatit gjyqësor mbi provat. Në këtë fazë të procedimit, në lidhje me këtë aspekt të procedurave, debati mbi provat në raport me faktin penal është i ndryshëm nga procesi i themelit, pasi qëllimi i tij është në drejtëm të verifikimit brenda afateve të shpejta të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm që lejon caktimin e një mase kufizuese të lirisë.

75. Gjykata vëren se vendimi nr. 94/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë për kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës "Arresti në burg" është marrë në dhomën e këshillimit, në mungesë të kërkuarit dhe përfaqësuesit të tij dhe është ekzekutuar të nesërmen në datën 27.7.2023. Në datën 28.7.2023, Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesë për marrjen në pyetje të kërkuarit dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg" edhe për kërkuarin, me arsyetimin se pas zhvillimit të seancës së marrjes në pyetje të të arrestuarve në përputhje me nenin 248 të KPP-së, ajo ka vlerësuar se nuk kanë ndryshuar nevojat e sigurimit. Në ankimet ndaj vendimeve nr. 94/2023 e nr. 97/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe në rekurs kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar gjatë seancës gjyqësore për marrjen në pyetje, sipas parashikimit të nenit 248 të KPP-së, si dhe cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

76. GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka zbatuar parimin e kontradiktoritetit dhe garancive të mbrojtjes (*shih faqet 15-16 të vendimit nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit*). Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë respektuar nenin 248 të KPP-së sipas qëllimit të tij dhe jo formalisht, duke u garantuar personave nën hetim të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur arsyet e tyre, duke garantuar kontradiktoritetin për aq sa mundëson kjo fazë e procedimit penal. Sipas Kolegjit Penal, gjatë marrjes në pyetje të personave nën hetim gjykatat e faktit kanë verifikuar kushtet e parashikuara në nenin 228 dhe kriteret e përcaktuara në nenet 229 dhe 230 të KPP-së. Në përfundim të këtij verifikimi, në prezencë të palëve dhe duke i dëgjuar ato, gjykata ka dalë në përfundimin se masa e sigurimit e caktuar fillimisht pa u dëgjuar të hetuarit, duhet të vijojë të zbatohet duke i dhënë përgjigje të argumentuar edhe pretendimeve të paraqitura nga ana e tyre (*shih paragrafin 115 të vendimit nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023 të Gjykatës së Lartë*).

77. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 29.7.2023 të zhvilluar në GJKKO-në e Shkallës së Parë për marrjen në pyetje të personave nën hetim, ashtu edhe përmbajtjen e vendimit të asaj, rezulton se ajo seancë është zhvilluar me pjesëmarrjen e kërkuarit dhe përfaqësuesve të tij. Në këtë seancë rezulton se, pas kërkesës së përfaqësuesit, është dëgjuar edhe kërkuari, i cili ka deklaruar

se nuk ka asnjë lidhje me çështjen për të cilën akuzohet. Në vijim, gjykata ka dëgjuar përfaqësuesit e kërkuar dhe nuk rezultoi që as ata dhe as vetë kërkuar të kenë kërkuar që ai të pyetet apo të flasë më tej, personalisht, përpara asaj gjykate. Për sa i përket seancës të zhvilluar në GJKKO-në e Apelit të datës 29.8.2023, për shqyrtimin e ankimit të kërkuar, referuar procesverbalit të asaj seance, rezultoi se ajo është zhvilluar në mungesë të kërkuar, i cili ka zgjedhur të mos paraqitet dhe është përfaqësuar nga avokatët e zgjedhur, që kanë parashtruar pretendimet e tyre përpara asaj gjykate. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuar, nëpërmjet mbrojtësve të tij, i është krijuar mundësia për të folur përpara gjykatës dhe për të deklaruar, pra për t'u dëgjuar brenda objektit të atij gjykimi në lidhje me ekzistencën e kushteve dhe kritereve për caktimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" ndaj tij.

78. Gjykata, duke pasur parasysh fazën në të cilën ndodhen procedurat, çmon se kërkuar i është garantuar e drejta për të kundërshtuar pretendimet e organit të akuzës për sa i përket ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm për pjesëmarrjen e tij në kryerjen e veprave penale që kanë justifikuar kufizimin e lirisë personale. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuar nuk ka kërkuar prova të reja, por pretendimi për mosparaqitjen nga prokuroria të certifikatës së vërtetësisë së deshifrimit të mesazheve të koduara është ngritur prej tij në kuadër të kundërshtimit të vetë akteve të paraqitura nga organi i akuzës, çka tregon se ai ka pasur të drejtë t'i kundërshtojë ato gjatë procesit gjyqësor dhe ka marrë përgjigje nga gjykatat në lidhje me to.

79. Për sa i përket pretendimit të kërkuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen për gjykim në seancë publike, në mënyrë që të garantohej e drejta e tij për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim, Gjykata rithekson qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e saj se vlerësimi nëse çështja duhet të shqyrtohet në dhomën e këshillimit ose në seancë publike u përket vetë kolegeve të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 38, datë 22.2.2023; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

80. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar.

81. Për sa më sipër, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuar për cenimin e lirisë personale në aspektin procedural është i pabazuar.

B.2 Për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial

B.2.1 Për dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova.

82. Kërkuar ka pretenduar se masa e sigurimit është caktuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm dhe bazuar në prova të marra nga autoritetet e drejtësisë franceze në kuadër të një procedimi penal në Lilë të Francës, në kundërshtim me legjislacionin shqiptar, ndërkohë që përdorimi i tyre në procesin penal në Shqipëri duhet të verifikohet sipas neneve 221–226 në lidhje me nenin 151, pika 3, të KPP-së. Sipas kërkuar, rezultatet e përgjimeve të bisedave të kryera prej abonentit me kod pin të atribuuar atij, janë të papërdorshme, pasi përgjimet janë autorizuar për llogari të procesit penal në Francë, për hetimin e veprave penale ku ai nuk ka qenë as i dyshuar, as person i identifikuar nga organet ligjzbatuese të atij shteti. Sipas kërkuar, atij i është atribuar *a priori* fakti se ishte përdorues i kodit pin përkatës në aplikacionin Sky ECC dhe se nuk ekziston asnjë provë konkrete që ta lidhë personalisht dhe drejtpërdrejt me veprat penale për të cilat është akuzuar. Kërkuar pretendon se në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë provë të ligjshme, të marrë në rrugë procedurale, që të vërtetojë se ai ka përdorur aplikacionin e inkriptuar me ose pa kodin e referuar në dosje nga autoritetet franceze. Po sipas kërkuar, autoritetet shqiptare nuk kanë kryer asnjë masë hetimore shtesë për të konfirmuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm ndaj tij, duke u dhënë në këtë mënyrë vlerë të paracaktuar rezultateve të paligjshme të përgjimeve të kryera në Francë. Sipas tij, gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh faktin se instrumentet ndërkombëtare të aplikuara nga pala shqiptare dhe ajo franceze në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar janë të ndryshme dhe autoritetet franceze të drejtësisë kanë vendosur kufizime për sa i përket përdorimit të transkripteve të dërguara përmes letërporosisë së tyre.

83. Kërkuar ka pretenduar se provat janë të papërdorshme, pasi përgjimi i realizuar nga autoritetet franceze ka qenë "i padrejtuar", me natyrë të "përgjimit masiv", që ndalohej nga legjislacioni shqiptar. Sipas kërkuar, transkriptet e komunikimeve të dërguara me CD nga autoritetet e drejtësisë franceze nuk janë prova me dokument apo prova digjitale të gjendura dhe të sekuestruara në serverët e platformës Sky ECC, sikurse kanë arsyetuar gjykatat, por janë rezultate të përgjimeve dhe këto

transkripte janë të papërdorshme, pasi janë në kundërshtim flagrant edhe me nenin 100-8 të Kodit të Procedurës Penale francez, si dhe procedurën e kërkuar nga nenet 706-95-20 të të njëjtit kod. Sipas tij, pavlefshmëria e transkripteve të përgjimeve lidhet edhe me faktin se në fashikullin gjyqësor nuk është paraqitur certifikata e vërtetësisë së deshifrimit të mesazheve të koduara, mungon akti “Informacion i Europol”, si dhe akte të tjera. Kërkuesi pretendon, gjithashtu, se vendimet e gjykatës franceze që legjitimonin përgjimin nuk ishin përfshirë në fashikullin e caktimit të masës së sigurimit dhe ai nuk ka pasur mundësinë objektive për të kundërshtuar procedurën e përgjimit përpara gjykatës së vendit të origjinës. Po sipas kërkuesit, aktet thelbësore procedurale që u paraqitën nga Prokuroria e Posaçme përmes shkresës së datës 11.5.2024, në një volum të ri hetimor në seancën paraprahe të zhvilluar në GJKKO-në e Shkallës së Parë, janë marrë nga dosja e procedimit penal nr. 26/2024 të Prokurorisë së Posaçme, përmes një procedurë të parregullt, pasi organi i akuzës nuk i ka kërkuar dhe nuk i ka marrë aktet në fjalë me letërporosi shtesë për llogari të procedimeve penale nr. 41/2023 dhe nr. 9/2023.

84. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se provat e administruara nga autoritetet franceze nuk janë të krijuara në territorin shqiptar, por nga një autoritet gjyqësor i huaj në funksion të hetimeve që ai po kryente në mënyrë të pavarur, të cilat kanë pasur për objekt vetë platformën Sky ECC, ndaj edhe përgjimi është drejtuar drejt serverëve të saj me vendndodhje në Francë. Ato prova janë kërkuar dhe marrë nga autoritetet shqiptare në zbatim të dispozitave të KPP-së, ligjit nr. 10193/2009, si dhe Konventës Evropiane “Për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale” dhe protokolleve shtesë të saj, përmes letërporosisë dhe bashkëpunimi gjyqësor në fushën penale mbështetet në prezumimin e respektimit të legjislacionit nga shtetet përkatëse, ndaj aktet e autoriteteve franceze të drejtësisë prezumohen se janë kryer në përputhje me legjislacionin vendas të atij shteti, derisa të provohet e kundërta. Po sipas Prokurorisë së Posaçme, procedura e ndjekur nga autoritetet franceze është në përputhje me dispozitat e KPP-së dhe aktet e mësipërme, ndërkohë që gjykatat kanë analizuar provat të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm, vlerën provuese të secilës prej tyre, si dhe përputhjen ndërmjet tyre. Sipas saj, pretendimi se përgjimi ka qenë i padrejtuar dhe është realizuar me një mjet teknik që ndërhyr në të gjithë fluksin e bisedave me natyrën e përgjimit masiv, i cili është i ndaluar nga legjislacioni shqiptar, është i pabazuar, ndërkohë që përgjimi i lejuar nga autoritetet franceze është urdhëruar nga një gjyqtar francez, në përputhje me legjislacionin francez dhe bazuar në nenet 221–226 të KPP-së është në përputhje edhe me dispozitat procedurale penale që rregullojnë përdorimin e përgjimeve si mjet kërkimi prove.

85. Subjekti i interesuar ka prapësuar se përgjimi i komunikimeve elektronike parashikohet në nenin 221 të KPP-së dhe veprat penale për të cilat është akuzuar kërkuesi, nisur nga marzhi i dënimit, parashikojnë përdorimin e përgjimit si mjet kërkimi të provës. Po sipas subjektit të interesuar, referuar dokumentacionit të ekzekutimit të letërporosisë, nuk rezulton që autoritetet franceze të jenë shprehur apo të kenë lënë të kuptohet për kufizime apo ndalime për përdorimin e të dhënave të dërguara. Subjekti i interesuar ka prapësuar se hetimi ka provuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se kërkuesi ka kryer veprat penale të atribuara dhe vendimet gjyqësore kanë arsyetuar rreth provave që krijojnë këtë dyshim të arsyeshëm, ndërsa transkriptet e komunikimeve nuk janë e vetmja provë ku janë mbështetur ato, ndërkohë që provat e tjera shkresore, shkencore dhe ato me dëshmitarë përputhen më së miri me të dhënat e përfutuara nga komunikimet në Sky ECC ndërmjet kërkuesit dhe bashkëpunëtorëve të tjerë në krim. Sipas Prokurorisë së Posaçme, dyshimi i arsyeshëm për caktimin e një mase siguri është forcuar gjatë fazës së mëtejshme të hetimit dhe sipas aktit të njoftimit të akuzës dhe kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim krahas transkripteve të komunikimeve në platformën Sky ECC janë administruar edhe prova të tjera që provojnë kryerjen e veprave penale. Sipas subjektit të interesuar, veprimet e tjera të kryera gjatë fazës së hetimit paraprahe konfirmojnë se kërkuesi është përdoruesi i kodit pin të atribuar atij.

86. Gjykata vëren se në kuptim të nenit 27, pika 2, të Kushtetutës “...*liria e personit nuk mund të kufizohet përveçse... kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veprë penale...*”. Qëllimi kryesor i kësaj dispozite kushtetuese është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një “shoqëri demokratike”. Po kështu, Gjykata ka theksuar se “dyshimet e arsyeshme” për kryerjen e veprës penale, që justifikojnë kufizimin e lirisë personale të individit, nënkuptojnë ekzistencën e fakteve ose informacioneve që arrijnë të bindin edhe

një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përket një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë personale nëse bazohet në fakte dhe informacione, të cilat krijojnë bindjen se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprës penale për të cilën akuzohet (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

87. Në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar në KPP. Një prej tyre është ai i caktimit të masës së sigurimit, që kërkon ekzistencën e disa kushteve të përgjithshme dhe të veçanta (*neni 228*), si dhe përmbushjen e disa kritereve (*neni 229*). Në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, kusht i domosdoshëm (*sine qua non*) për caktimin e masës së sigurimit është ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individ i ka kryer një vepër penale (*neni 228, pika 1*).

88. Sipas nenit 5, pika 1, shkronja “c”, të KEDNJ-së “*Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve... kur arrestohet... për t’u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një vepër penale...*”. Sipas GJEDNJ-së, nëse një person ndalohej sipas kësaj dispozite të Konventës, “gjykata” duhet të jetë e autorizuar të shqyrtojë nëse ka ose jo prova të mjaftueshme për të krijuar një dyshim të arsyeshëm se individ i ka kryer një vepër penale, pasi ekzistenca e një dyshimi të tillë është thelbësore nëse burgimi duhet të jetë “i ligjshëm” sipas Konventës (*shih Dimo Dimov dhe të tjerët kundër Bullgarisë, 2020, § 70*). Nëse gjykata nuk jep arsyet e duhura ose jep vendime stereotipe të përsëritura që nuk japin përgjigje për argumentet e kërkuarit, kjo mund të passjellë një shkelje që cenon garancitë e nenit 5, paragrafi 4, (*shih G.B. dhe të tjerët kundër Turqisë, 2019, § 176*). Në ushtrimin e funksionit të saj GJEDNJ-ja duhet të sigurojë që argumentet e gjykatave kombëtare *pro* dhe *kundër* lirisë nuk duhet të jenë “të përgjithshme dhe abstrakte”, por të përmbajnë referenca për fakte specifike dhe rrethanat personale që justifikojnë masën e sigurimit (*shih Hysa kundër Shqipërisë, §§ 66, 68, datë 21 shkurt 2023*).

89. Po sipas GJEDNJ-së, që gjykata të jetë e bindur për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, elementet që i paraqiten duhet të jenë specifike, në kuptimin që duhet të tregojnë veprimin ose mosveprimin që dyshohet se ka kryer individ, duke i evidentuar ato, si dhe duke shpjeguar lidhjen që ekziston ndërmjet fakteve dhe veprës së dyshuar. Përdorimi i një prove elektronike që vërteton se një individ përdor mesazhe të koduara të krijuara posaçërisht dhe është përdorur ekskluzivisht nga një organizatë kriminale për qëllime të komunikimit të brendshëm të saj mund të përbejë një instrument shumë të rëndësishëm në luftën kundër krimit të organizuar. Rrjedhimisht, një provë e tillë mund të çojë me të drejtë, fillimisht, të ndalimi i një individ për aq sa mund të provohet dukshëm se ky individ i përket një organizate të tillë (*shih Angun kundër Turqisë nr. 19699/18, datë 20 korrik 2021, §§§ 153, 155 dhe 167*). Vetëm kur përdorimi i një mjeti të koduar komunikimi mbështetet nga elemente të tjera që lidhen me përdorimin e tij, siç është përmbajtja e mesazheve të shkëmbyera ose konteksti në të cilin ato janë shkëmbyer, ose nga lloje të tjera elemente të lidhura, atëherë mund të kemi të bëjmë me prova të mjaftueshme objektive bindëse për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm (*shih Angun kundër Turqisë nr. 19699/18, datë 20 korrik 2021, § 173*).

90. Gjykata thekson se në këtë fazë të procedimit penal gjykatat bazohen në ato të dhëna, informacione apo fakte objekt prove mbi të cilat organi që procedon mbështet kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe të cilat, po në konsideratë të kësaj faze, duhet të krijojnë dyshimin e arsyeshëm se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale. Në këtë kuptim, dyshimi i arsyeshëm nuk është imagjinar edhe pse bazuar në këto të dhëna, informacione apo fakte objekt prove nuk mund të pohohet me bindje të palëkundur vlefshmëria e akuzës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se të dhënat, informacionet apo faktet objekt prove në këtë fazë të procedimit penal nuk kërkohet që të jenë në të njëjtin nivel provueshmërie me ato mbi të cilat bazohet vendimi i themelit që ka të bëjë me (pa)fajësinë e të pandehurit dhe gjatë të cilit do të formësohen edhe provat që kanë të bëjnë me të provuarit e akuzës penale.

91. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson të theksojë dallimin që ekziston midis konceptit të provave të cilat shërbejnë për vërtetimin e fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe atyre të dhënave, informacioneve apo fakteve, objekt prove, të cilat shërbejnë për krijimin e dyshimit të arsyeshëm se personi nën hetim mund të ketë kryer veprën penale. Gjykata thekson se provat formësohen në

procesin penal të themelit në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve dhe garancitë e tjera të një procesi të drejtë, që qëndrojnë në themel të procesit gjyqësor penal. Në këtë prizëm, Gjykata do të vlerësojë nëse të dhënat, informacionet apo faktet që ishin në dispozicion të organeve proceduese në kohën kur ndaj kërkuesit u vendos masa e sigurimit personal ishin ose jo të tilla që, në tërësinë e tyre, formojnë dyshimin e arsyeshëm për të justifikuar në rastin konkret kufizimin e lirisë së tij me masën “Arresti në burg”. Gjykata thekson, gjithashtu, se garancitë e nenit 27, pika 2, të Kushtetutës duhet të gëzohen të plota nga subjekti i procedimit penal pikërisht në kohën e caktimit të masave të sigurimit personal. Çdo qëndrim i ndryshëm do të çonte në heqjen arbitrare ose të pajustificuar të lirisë personale.

92. Në këtë kuptim, Gjykata do të vlerësojë nëse në rastin konkret: (i) është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit; ii) nëse ky dyshim është formuar vetëm mbi komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC apo edhe mbi të dhëna, informacione apo fakte të tjera objekt prove.

93. Gjykata konstaton se autoritetet gjyqësore franceze prej datës 24.6.2019, në kuadër të një hetimi penal francez, urdhëruan një masë përgjimi në serverët e Sky ECC në OVH në Roubaix, Francë, ku u interceptuan të dhëna të enkriptuara dhe metadata që fillimisht nuk ishin të lexueshme, por mundësuan një analizë teknike që lejoi të krijohej një panoramë e rëndësisë së kodeve pin të caktuara (përdoruesit e aplikacionit Sky ECC) dhe rëndësisë së marrëdhënieve që mbaheshin me kode pin të tjera të caktuara. Gjithashtu, enkriptimi dhe konfigurimi i sistemit iu nënshtruan një hetimi teknik që me kalimin e kohës mundësoi dekriptimin. Dekriptimi substancial u vendos dhe u krye vetëm prej datës 15.2.2021, kur përfundimisht u mor konfirmimi i treguesve të rëndë të fajësisë, që komunikimi dhe shërbimi i aplikacionit Sky ECC, për aq sa mund të zbulohej përmbajtësisht, ishte i natyrës kriminale *à charge* dhe *à décharge* në favor të organizatave kriminale ose bashkimeve kriminale. Në këtë kontekst, rezulton se përgjimet në kohë reale në aplikacionin Sky ECC kanë filluar në muajin shkurt 2021, ndërsa prej datës 24.6.2019 ka pasur prova të ftohta, të vjetra, të nxjerra nga serverat para se të fillonin këto përgjime.

94. Komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC u janë përcjellë autoriteteve shqiptare nga autoritetet gjyqësore franceze përmes letërporosisë në bazë të parashikimeve të KPP-së dhe të Konventës së Këshillit të Evropës “Për bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën penale”. Autoritetet gjyqësore franceze kanë vepruar në ekzekutim të letërporosisë së dërguar nga autoritetet e drejtësisë shqiptare, për transmetimin e të dhënave nga përgjime të marra prej Gjykatës së Parisit, në përputhje me nenin 3 të Konventës së Këshillit të Evropës, në bazë të së cilit parashikohet parimi i përgjithshëm i prezumimit të ligjshmërisë së marrjes se tyre nga autoritetet gjyqësore të një shteti anëtar të Konventës për ndihmë juridike në fushën penale. Gjykata vëren se në bazë të nenit 26, pika 1, të Konventës “Për krimin në fushën e kibernetikës”, të ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002, parashikohet edhe dhënia e informacionit spontan dhe, sipas saj, brenda kufijve të ligjit të brendshëm dhe pa kërkesë paraprake, një palë mund t’i ofrojë një palë tjetër informacionin e marrë në kuadrin e hetimeve të veta kur konsideron se dhënia e një informacioni të tillë mund të ndihmojë palën marrëse në fillimin ose kryerjen e hetimeve ose gjykimeve në lidhje me veprat penale të përcaktuara në këtë Konventë ose mund të çojë në bërjen e një kërkesë për bashkëpunim nga kjo palë. Për rrjedhojë, Gjykata vëren se komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC janë përcjellë nga autoritetet franceze në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë mes autoriteteve të të dyja vendeve, pra në përputhje me parimin e besimit reciprok në marrëdhëniet mes autoriteteve gjyqësore të huaja.

95. Po kështu, Gjykata vëren se në drejtim të krijimit të dyshimit të arsyeshëm, si standardi që kërkohet të përmbushet në këtë moment dhe fazë të procedimit penal, ai nuk rezulton të jetë bazuar vetëm në komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC të marra përmes letërporosisë, por edhe mbi të dhëna të tjera të përfuara gjatë veprimtarisë hetimore apo të marra nga procedime të tjera penale, të cilat, në tërësinë e tyre, nuk duket se kanë qenë të pamjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm, si kushti *sine qua non* për kufizimin e lirisë personale të kërkuesit. Siç kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme në këtë drejtim, dyshimi i arsyeshëm nuk është bazuar vetëm në komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC, por edhe në provat e tjera materiale, provat dokument apo ato të

zbuluara përmes veprimeve të papërsëritshme nga organi procedues, të cilat janë analizuar nga ato gjykata.

96. Gjykata, pa paragjykuar (pa)fajësinë e kërkuesit për kryerjen e veprave penale për të cilat është caktuar masa e sigurimit “Arresti në burg”, ashtu edhe vendimmarrjen në përfundim të procesit penal ndaj tij, vlerëson të theksojë se në gjykimin në themel, në të cilin merren dhe formësohen provat, kërkuesi ka mundësinë dhe të drejtën që të kundërshtojë, në drejtim të ligjshmërisë dhe përdorshmërisë së tyre, edhe komunikimet e kryera në aplikacionin Sky ECC të marra përmes letërporosisë nga autoritetet franceze, si në këndvështrim të mënyrës dhe formës së marrjes së tyre, ashtu edhe pajtueshmërisë së tyre me parashikimet e dispozitave të KPP-së, referuar si aspekteve që kanë të bëjnë me përgjimin masiv apo të padrejtuar, ashtu edhe lidhjes së kërkuesit me abonentin e kodit pin që i është atribuar atij. Janë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm që kanë kompetencën të vlerësojnë, gjatë procesit të formësimit të provave në procesin penal, edhe ato pretendime që kanë të bëjnë me aspekte të (pa)vlefshmërisë dhe (pa)përdoshmërisë së provave, në përputhje me parimet dhe garancitë e së drejtës për proces të drejtë ashtu edhe me parimet e sanksionuara në nenin 32, pika 2, të Kushtetutës, që ndalon deklarimin fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, si dhe nenin 30 të Kushtetutës për prezumimin e pafajësisë.

97. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit në këtë drejtim janë të pabazuara.

B.2.2 Për të drejtën për t’u proceduar në liri kundrejt garancisë pasurore

98. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë respektuar të drejtën e tij për t’u proceduar në liri, kundrejt *garancisë pasurore*. Sipas kërkuesit, gjykatat, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, duhet të pranonin kërkesën për masën alternative të sigurimit personal “Garancia pasurore”, sipas nenit 236 të KPP-së dhe t’i kërkonin Prokurorisë së Posaçme të plotësonte dosjen hetimore me akte të tjera që lidheshin me rezultatet e përgjimeve të autoriteteve gjyqësore franceze, ndërkohë që kërkuesi duhet të procedohej në liri. Po sipas tij, në vendimet e tyre gjykatat e zakonshme nuk kanë shqyrtuar dhe as kanë vënë në diskutim kërkimin për ndryshimin dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

99. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u liruar kundrejt garancisë pasurore është i pabazuar, pasi gjykatat kanë arsyetuar se përse ndaj kërkuesit duhej të caktohej masa e sigurimit e parashikuar nga neni 238 i KPP-së. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar lidhur me përshtatshmërinë e kësaj mase në funksion të caktimit të saj në mënyrë proporcionale dhe të përshtatshme, duke mbajtur parasysh kriteret e parashikuara nga neni 229 i KPP-së, qasje kjo e mbështetur nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë.

100. Gjykata vëren se, sipas nenit 28, pika 3, fjalia e dytë, të Kushtetutës, i paraburgosuri ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt *një garancie pasurore* sipas ligjit. Këto garanci gjenden edhe në paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1, shkronja “c”, të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit, lirim që mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor.

101. Sipas GJEDNJ-së, pjesa e dytë e paragrafit 3 të nenit 5 të KEDNJ-së nuk u jep autoriteteve gjyqësore një zgjedhje midis ose dërgimit të personit të akuzuar në gjyq brenda një kohe të arsyeshme ose lirimit të përkohshëm në pritje të gjykimit. Deri në dënimin e tij personi i akuzuar duhet të prezumohet i pafajshëm dhe qëllimi i kësaj dispozite është, në thelb, që ai të kërkojë lirimin e përkohshëm atëherë kur vijimi i paraburgimit pushon së qeni i arsyeshëm. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së (*shih Guidën e nenit 5 të KEDNJ-së “E drejta për liri dhe siguri”, §§ 205, 206*).

102. Vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimit të paraburgimit. Kur autoritetet gjyqësore shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, ky dyshim nuk mjafton më dhe autoritetet duhet të japin arsye të tjera relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DhM], 2017, § 222; *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* [DhM], 2016, § 102). Iu takon autoriteteve të përcaktojnë qëndrueshmërinë e shkaqeve që justifikojnë vazhdimin e paraburgimit (shih *Merabishvili kundër Gjeorgjisë* [DhM], 2017, § 234) dhe barra e provës nuk duhet të kthehet duke i kërkuar personit të ndaluar që të provojë ekzistencën e arsyeve që garantojnë lirimin e tij (shih *Bykov kundër Rusisë* [GC], 2009, § 64). Për rrjedhojë, vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të ketë një kontroll publik të administrimit të drejtësisë (shih *Tase kundër Rumanisë*, 2008, § 41).

103. Për sa më sipër, Gjykata vëren se në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së e drejta e personit ndaj të cilit është caktuar një masë sigurimi me heqje lirie për të kërkuar lirimin e tij kundrejt garancisë pasurore përbën një të drejtë kushtetuese dhe, nga ana tjetër, një detyrim për autoritetet gjyqësore që ta shqyrtojnë atë, duke vlerësuar nëse masa e heqjes së lirisë e ka humbur qëllimin e saj pasi nuk justifikohet më me arsye të interesit publik. Në këtë kuptim, i paraburgosuri ka të drejtë që të kërkojë procedimin e tij në liri dhe zëvendësimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, në zbatim të nenit 236 të KPP-së, dhe gjykatat janë të detyruara të marrin në konsideratë nëse ka ende arsye që justifikojnë masën kufizuese të lirisë dhe nëse nevojat e sigurimit mund të garantohen me garanci të tjera ose masa alternative, duke vlerësuar në çdo rast proporcionalitetin e masës së caktuar në drejtim të përshtatshmërisë së saj. Për rrjedhojë, Gjykata do të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë vlerësuar në rastin konkret ekzistencën e kriterëve që justifikojnë vijimin e masës së sigurimit “Arresti në burg” të caktuar ndaj kërkuarit.

104. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për caktimin ndaj tij të masës shtrënguese “Garancia pasurore”, të parashikuar nga neni 236 i KPP-së, Gjykata vëren se për sa u përket kriterëve të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, sipas nenit 229 të KPP-së, gjykata mban parasysh *përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit* që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast, mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Gjykata vëren se sipas nenit 238 të KPP-së përmes masës shtrënguese “Arresti në burg” gjykata urdhëron qëndrimin e personit në një institut paraburgimi. Për sa i përket garancisë pasurore, si një lloj tjetër i masave shtrënguese, neni 236 i KPP-së, pikat 1 dhe 2 të tij, parashikon se kur është caktuar masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, gjykata mund të vendosë zëvendësimin e saj, duke urdhëruar lirimin e personit, nëse është ofruar garanci pasurore nga ai vetë ose një person tjetër për moslargimin e tij deri në përfundimin e gjykimit. Gjykata pranon garancinë pasurore në të njëjtat kushte si në paragrafin e mësipërm edhe kur ndaj personit duhet të caktohet masa e sigurimit arrest në burg ose arrest në shtëpi, për shkak të ekzistencës së rrezikut të ikjes, duke lejuar qëndrimin e tij në gjendje të lirë.

105. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka gjetur të mbështetur në ligj dhe në prova kërkesën e paraqitur nga Prokuroria e Posaçme për caktimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, pasi ka vlerësuar se çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme në raport me kushtet dhe kriteret e nevojat e sigurimit. Në caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, ajo gjykatë ka mbajtur parasysh rrezikshmërinë e theksuar shoqërore të veprave penale që dyshohet se ka kryer personi nën hetim, marrëdhëniet juridike që janë prekur nga këto vepra penale, pasojat që ka sjellë veprimtaria e paligjshme jo vetëm në aspektin personal të viktimave konkrete të veprave penale, por edhe te besueshmëria që duhet të krijojnë institucionet në komunitet, si dhe nevoja për të parandaluar ngjarje të tjera të rënda (shih *fajen 123 të vendimit nr. 94/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë*). Edhe në seancën e rivlerësimit të masës së sigurimit, e njëjta gjykatë ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në burg” për kërkuarin, pasi ka vlerësuar se për shkak të natyrës së veprave penale ku është përfshirë dhe rrezikshmërisë së tyre shoqërore, mënyrës së si ka vepruar në kuadër të veprimtarisë kriminale, ka rrezik eminent që të kryejë vepra të tjera penale (shih *fajen 113 të vendimit nr. 97/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

106. GJKKO-ja e Apelit e ka vlerësuar të drejtë konkluzionin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke vlerësuar se gjyqtari i hetimeve paraprake ka caktuar masën e sigurimit “Arresti në burg” për kërkuesin, sepse një masë e tillë është masa proporcionale më e përshtatshme me shkallën e nevojave të sigurimit, në këndvështrim të rëndësisë së faktit penal, sanksionit dhe rrethanave rënduese që ekzistojnë së bashku me dyshimin për kryerjen e veprave penale të atribuara. Nuk verifikohet se ekzistojnë rrethana lehtësuese nga ato të parashikuara në nenin 48 të KP-së, në lehtësim të rrethanave të presupozuara të kryerjes së veprave penale. Po sipas GJKKO-së së Apelit, masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” e kërkuar nga kërkuesi është e papërshtatshme për të ndaluar të hetuarin që të ndërpresë kontaktet me subjektet e tjera, me të cilat dyshohet se veçanërisht ka bashkëpunuar, për shkak të mënyrave se si ka proceduar për kryerjen e veprave penale në kuadër të krimit të organizuar të atribuuar. Po kështu, ajo gjykatë e ka çmuar si të papërshtatshme edhe masën e sigurimit “Garancia pasurore”, duke theksuar se duhet të përjashtohet përshtatshmëria e çdo mase tjetër *in melius*, pasi kërkuesi nuk është i prirur të respektojë në mënyrë spontane urdhrat e autoriteteve gjyqësore dhe atyre policore (*shih faqet 107 dhe 108 të vendimit nr. 38/2023 të GJKKO-së së Apelit*).

107. Vendimi i GJKKO-së së Apelit është vlerësuar i drejtë në vijim nga Gjykata e Lartë në drejtim të parimit të proporcionalitetit. Sipas Gjykatës së Lartë, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar drejt proporcionalitetin e masës së caktuar në raport me rrethanat e faktit, sanksionit të veprave penale si dhe rrethanave lehtësuese dhe rënduese. Sipas saj, personat nën hetim dyshohet të kenë konsumuar vepra penale të rënda, në formën e një bashkëpunimi të veçantë, çka tregon rrezikshmërinë e lartë të veprës së kryer ashtu edhe të autorëve të saj (*shih paragrafin 114 të vendimit nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

108. Në analizë të vendimeve të mësipërme gjyqësore për qëllime të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata çmon se masa e sigurimit personal “Arresti në burg” është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit e rëndësinë e faktit penal për të cilin ai dyshohet dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal “Arrest në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së.

109. Kurse për sa i përket pretendimit për cenimin e nenit 28, pika 3, të Kushtetutës Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kërkon që masa e heqjes së lirisë të ketë humbur qëllimin e saj, pra të mos justifikohet më me arsye të interesit publik, vlerëson se paraqitja e kërkesës për t’u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore kërkon kalimin e një periudhe kohe, pas së cilës gjykata mund të verifikojë nëse ekzistojnë më kushtet dhe nevojat e sigurimit. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete dhe pretendimet e kërkuesit, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës¹.

¹ Gjyqtaret Holta Zaçaj dhe Sonila Bejtja, edhe pse i janë bashkuar qëndrimit se në rastin konkret nuk ka shkelje të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës e kanë konsideruar të pabazuar këtë pretendim vetëm mbi arsyet që lidhen me proporcionalitetin, në drejtim të përshtatshmërisë, të masës së kufizimit të lirisë personale të caktuar ndaj kërkuesit. Në vlerësimin e tyre, gjykatat kanë marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit për caktimin e një mase më të lehtë dhe kanë dhënë argumentet se përse asnjë masë tjetër shtrënguese, përtej asaj “Arresti në burg”, nuk ishte përshtatshme në raport me nevojat e sigurimit në rastin konkret. Kurse për sa i përket përmbajtjes së pikës 3 të nenit 28 të Kushtetutës, në vlerësimin e këtyre gjyqtareve ajo nuk nënkupton kalimin e një periudhe kohe për t’i lindur e drejta personit nën hetim për të kërkuar lirinë e tij. Kjo dispozitë kushtetuese ka parashikuar si garanci për individin që ose të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm në rast se ndaj tij caktohet masa shtrënguese “Arresti në burg” ose “Arresti në shtëpi”, ose të procedohet i lirë. Ashtu siç ka theksuar edhe GJEDNJ-ja, kur autoritetet gjyqësore shqyrtojnë për herë të parë, “menjëherë” pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, ky dyshim nuk mjafton më dhe autoritetet duhet të japin arsye të tjera relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar paraburgimin (*shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë [DhM], 2017, § 222; Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], 2016, § 102*). Në këtë kuptim, elementi kohë e arsyeshme në këtë dispozitë lidhet vetëm me rastin kur gjykata nuk pranon procedimin e lirë për shkak të përmbushjes së nevojave të sigurimit por vendos paraburgimin e personit. Kjo do të thotë se personi ndaj të cilit është caktuar masa shtrënguese “Arresti në shtëpi” ose “Arresti në burg” mund të kërkojë në çdo kohë, që në momentin e paraqitjes përpara gjyqtarit për vlefësimin e masës, lirinë e tij kundrejt garancisë pasurore dhe është gjykata që vlerëson nëse një masë e tillë përmbush nevojat e sigurimit në atë procedim penal.

110. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit në drejtim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës është i pabazuar, ndërkohë që në lidhje me pretendimin për zbatimin e nenit 236 të KPP-së ajo vlerëson se masa e sigurimit “Arresti në burg” e caktuar ndaj kërkuarit nuk është joproporcionale.

111. Për sa më lart, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e lirisë personale në aspektin substancial është i pabazuar.

112. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit në drejtim të lirisë personale, në aspektin procedural dhe substancial të saj, janë të pabazuara, sipas arsytimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “P” dhe 134, pika 1, shkronjat “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 30.12.2024.

Shpallur, më 12.2.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Përndryshe kjo dispozitë kushtetuese do të humbte vlerën e saj, ashtu si edhe e drejta e sanksionuar në të, sikundër edhe parashikimi i “Garancisë pasurore” si masë shtrënguese në nenin 236 të KPP-së, ndërkohë që procedimi i lirë i personit nën hetim, pas kalimit të një afati kohor, mund të kërkohej edhe për shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato që parashikon neni 28, pika 3, i Kushtetutës.